



Maratona *e tre muajve të mirë*



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Erzen Carja

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXIII i botimit
Nr. 01 (488)
Janar, 2024

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

4 Koncepti i adhurimit në tre muajt e begatë / Mehmet Disha

8 Ata që u ngritën, u ngritën më anë të modestisë / Taulant Bica

10 Lajme / Aktivitete



14 Një panoramë e shkurtër për ringritjen e Komunitetit Mysliman
pas përmbyesjes së diktaturës komuniste / Xhernal Balla

16 33 Vjet nga rihapja e xhamisë “Et’hem Beu” / Dorian Demetja

18 Disa specifika rreth guslit te gratë II / Fatma Karaj

20 Tregu i Medines / Erjol Haxhiu

22 Lutja, një kandil ndriçues në errësirën e kësaj bote / Abdullah Bulku

24 Nata e mirë Regaib / Redaksia

26 Morali i lartë i Resulullahut dhe sjelljet e tij,
që u bënë shkak për udhëzimin e njerëzve / M. Jusuf Kandeheui



28 Njeriu vuan... nga zëmra / Beqir Haçi

32 Qamil Bala (1878-1933) / Personalitet

36 Idhujt e gjallë, Lat, Uzza, Menat / Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi

38 Kujdesi për jetimin / Redaksia



Koncepti i adhurimit në tre muajt e begatë

Njeriu në natyrën e vet është adhurues. Njeriu nuk mund të shndërrohet nga adhurues në jo adhurues. Ai mund të kalojë nga një lloj adhurimi në një tjetër. Nuk është zgjedhja mes adhurimit dhe jo adhurimit, sikundër bëri sistemi bashkëkohor, por zgjedhja është vetëm tek i adhuruari, a është Allahu i Madhëruar, apo diçka tjetër. Zgjedhja sipas shprehjes kuranore është mes adhurimit të Allahut dhe adhurimit të shejtanit: **“Vallë, a nuk ju kam urdhëruar, o bijtë e Ademit, që të mos e adhuroni djallin, se ai është vërtet armiku juaj i shpallur, por të më adhuroni vetëm Mua?! Kjo është rruga e drejtë.” (Jasin: 60-61)**

Rruga e drejtë është ajo që të çon në njohjen dhe adhurimin e Allahut, ndërsa rrugët e shejtanit të orientojnë drejt prishjes, shkatërrimit dhe mohimit. Të adhuruarit në sistemin bashkëkohor është i ndryshëm dhe rrugët e tij janë të shumta gjithashtu, nga adhurimi i dollarit/euros në adhurimin e dëshirave dhe epsheve, duke kaluar te prodhimi dhe “interesat kombëtare”, “shkenca dhe mendja”, “përparimi dhe zhvillimi”, “idetë personale”, “natyra dhe humanizmi”.

Çdo i adhuruar prej këtyre ka detyrimet e veta që duhet t'i bindesh... Ku shkon njeriu kur del nga adhurimi i Allahut? Bota bashkëkohore thotë se ai çlirohet nga vargonjtë. Po, çlirohet nga prangat njerëzore, që të bjerë në ato shtazore. Adhurimi padyshim është varësi, sepse është detyrim me atë që Allahu zbriti robërim e pengim të epsheve dhe dëshirave, por në të njëjtën kohë ai e çliron njeriun nga presioni i epsheve dhe nënshtrimi poshtërues i njerëzve që marrin dinjitetin e njeriut. “Adhuroje Allahun sikur ta shihje Atë. Dhe nëse ti nuk e sheh Atë, padyshim Ai të sheh ty!” (Buhari, Iman: 37)

Adhurimi është nënshtrim i mbushur me dashuri. Është bindshmëria e njeriut që dashuron atë që ai nderon dhe respekton. Është një qëndrim që i shkon për shtat natyrës së njeriut kundrejt vetëm Zotit. Adhurimet janë vërtetim besnikërie që tregojnë se robi i qëndron besnik marrëveshjes së bërë me Zotin e vet në zanafillë (pafillimshmëri). Adhurimet janë një botë krejt private, ku njeriu e qetëson dhe e forcon shpirtin me kënaqësinë se po bën diçka vetëm për pëlqim të Zotit të vet. Adhurimet janë burimi më me efekt i shërimit

dhe qetësimi që mundet ta çlirojë njeriun nga dyshimet dhe shqetësimet e përtej vdekjes, janë klimë shpirtërore nëpër të cilën kalon rruga e vetme e investimeve që bëhen për botën e përtejme. Me këto cilësi, adhurimet janë burim begatie që kurrësi s'duhet nënvlerësuar në rrugën e sigurimit të ekuilibrit dhe paqimit të zemrës.

Për të vjelur rezultatin e dëshiruar nga adhurimet, është kusht që ato të kryhen me përsëritshmëri, dhe përsëritshmëria është qëndrimi para audiencës hyjnore në bashkëveprimin e qetësisë dhe kënaqësisë së zemrës me ndjenjat e dashurisë dhe frikës, është shkëputja e të gjitha lidhjeve të jashtme për të qenë bashkë me Zotin dhe arritja e vetëdijes së krijimit vetëm për ta adhuruar Atë! "Unë krijova xhindet dhe njerëzit vetëm për të më adhuruar Mua." (Dharijat: 56) "Thuaj: Zoti im nuk do t'ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj. Por ju (i) keni përgënjeshtruar (Shpalljet e Tij), andaj dënimi për ju do të jetë i pashmangshëm" (Furkan: 77)

Zoti me anë të këtyre ajeteve deklaroi se, që njeriu të shpëtojë nga disfatat e amshuar, duhet ta shoqërojë besimin

me adhurim dhe punë të mira. Kështu, besimtarët që kanë vënë si synim të dalin në audiencën e lartë të Zotit me zemër të pastër, ua dorëzojnë zemrat burimeve sublime të adhurimeve, të quajtura punë të mira dhe marrin rrugën drejt detit të afrisë hyjnore. Adhurimet, të cilat janë simbol i besimit dhe ushqim i shpirtit tonë, e përforcojnë besimin tonë duke pastruar brendinë tonë nga mendimet e këqija dhe anën tonë të jashtme nga ndytësitë e mëkateve, duke na shndërruar në besimtarë të plotë me moral dhe virtyte të larta. Përkufizimi tradicional i adhurimit në Islam përfshin pothuajse çdo gjë në aktivitetin e individit. Të gjitha veprimet e njeriut duhet të jenë në pajtim me udhëzimet e Atij të cilit njeriu i nënshtrohet. Në Islam puna e denjë konsiderohet një lloj adhurimi, ndërsa të kërkuarit e diturisë është një ndër llojet më të larta të adhurimit. Mirësjellja ndaj anëtarëve të familjes së dikujt, apo mirësjellja shoqërore ndaj familjes së madhe njerëzore dhe bashkëpunimi i mirëfilltë janë pjesë e adhurimit kur bëhen për hir të Allahut. Pra, koncepti i adhurimit në Islam është koncept i gjerë, që përfshin të gjitha

aktivitetet pozitive të individit. Ai është rregullatori i jetës së njeriut në të gjitha nivelet: atë individual, shoqëror, ekonomik, politik dhe shpirtëror. Është element shumë domethënës kur dikush kupton se të gjitha aktivitetet e tij konsiderohen nga Allahu si vepra adhurimi. Adhurimi në Islam, qoftë ai ritual apo joritual, e ushtron individin në atë mënyrë që ai të jetë më i afërt dhe ta dojë më së shumti Krijuesin e tij dhe, me anë të kësaj, të fitojë vullnet dhe entuziazëm të paepur, për t'i fshirë të gjitha të këqijat dhe brengat nga shoqëria njerëzore dhe ta bëjë emrin e Zotit dominues në botë.

Koha dhe vendi të gjithë vlerën dhe shenjtërinë e tyre e marrin sepse ashtu dëshiron Allahu. Kjo dëshirë hyjnore përfshin mijëra urtësi për krijesat, veçanërisht ato ngjarje që ndodhin brenda asaj kohe dhe vendi, i fitojnë këtyre një rëndësi të veçantë. Shenjtëria e disa aspekteve të kohës në Islam është një mënyrë që begatia dhe mirësia e pafund e Zotit të mbërrijë te myslimanët. Sipas kalendarit hënor, që ka si pikënisje Hixhretin e profetit Muhamed a.s., muajt Rexheb, Shaban dhe Ramazan janë muajt shumë të dobishëm dhe të bekuar. Në shoqërinë islame këta muajt quhen "Shuhur-u thelathë" (Tre Muajt). Të gjitha netët e mira veç Natës së Mevludit, ndodhen brenda këtyre tre muajve. Muaji Rexheb cilësohet si muaji i mbjelljes, muaji Shaban si muaji i ujitjes dhe muaji Ramazan si muaji i korrjes apo mbledhjes së prodhimeve. Njeriu korr ç'ka mbjell, merr të barazvlefshmen e asaj që ka bërë. Tre muajt kanë një shije të vetën, e cila i veçon ata nga muajt e tjerë. Secili nga muajt ndjehet me ndjenjat tona të dukshme, ndërsa këta të tre, ndjehen me zemër dhe ndjenja mjaft të thella. Brenda kësaj kohe njerëzit që i kthehen botës së zemrës, preken shpirtërisht nga rrezet që burojnë nga besimi i tyre dhe u duket se në këtë gjendje ata do të jetojnë përgjithmonë në hare. Ditët, netët, madje orët dhe minutat gjatë kësaj kohe për ta ecin në një formë të magjishme. E ashtu duke rrjedhur, pa dyshim që secilit i pëshpërijnë diçka në shpirt... Gjatë këtyre muajve myslimanët pendohen për mëkatet; zemërimeve dhe mërive u jepen fund, ndjenjat vëllazërore zhvillohen më tej, kështu, myslimanët bëjnë përpjekje për të hyrë me mendime të mira dhe kënaqësi në muajin e bekuar të Ramazanit. Muaji Rexheb është muaji i faljes, amnistisë nga Allahu; muaji Shaban është muaji i shefaatit, ndërmyjetësimit për falje; muaji Ramazan është muaji i shtimit të mirësive. Për këtë qëllim Profeti ynë në fillim të Rexhebit lutej kështu: "Allahu im! Na i bëj të bekuar Rexhebin dhe Shabanin dhe na bashko me Ramazanin!" (Ahmed, 1, 259) Muaji Shaban është muaji i tetë sipas kalendarit hënor, muajt ky i cili i paraprën muajit të agjërimit, ose muajit të Kur'anit-Ramazanit. Ky është muaji i

begative madhështore, që i nxit myslimanët që të shfrytëzojnë rastin për të përfituar shpërblime të mëdha si dhuratë nga Allahu xh.sh. për veprimet e mira dhe produktive gjatë këtij muaji. Pikërisht në këtë muajt kanë ndodhur dy ngjarje të mëdha për mbarë myslimanët: Nata e Beraetit apo nata e katërbëdhjetë e muajit Shaban dhe ndërimi i Kibles prej Mesxhidi Aksasë (Jeruzalemit) në drejtim të Mesxhidi Haramit. Nëna e besimtarëve Aishja r.a ka thënë: "Pejgamberin a.s. nuk e kam parë që ka agjëruar muajt të plotë përveç Ramazanit, e as nuk e kam parë se ka agjëruar ndonjë muajt më shumë se sa në muajin Shaban." (Buhariu: 1833) Ky muajt është parapërgatitje me qëllim që besimtarët myslimanë të presin muajin e agjërimit me zemra të hapura dhe të pastra. Muaji i Ramazanit është muaji në të cilin filloi të zbrësë Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues i së vërtetës nga e pavërteta. Është muaji në të cilin është zhvilluar lufta e Bedrit, lufta e parë për ngritjen e fesë së Zotit dhe për mbrojtjen e jetës dhe identitetit të myslimanëve. Është muaji në të cilin gjendet një natë që është më e vlefshme se njëmijë muajt dhe muaji gjatë të cilit myslimanët e shëndoshë fizikisht dhe ata që janë në vendin e lindjes së tyre janë të obliguar ta kryejnë kushtin e tretë të fesë islame, që është agjërimi. Kur afrohej muaji i Ramazanit, Pejgamberi a.s. përgatitej në të gjitha aspektet: agjëronte shumë ditë në muajin Shaban, shumë netë të tij i kalonte në adhurim, u fliste shokëve të tij për vlerën e muajit të Ramazanit. Transmetohet nga Selman Farisiu se Pejgamberi a.s. në ditën e fundit të muajit Shaban, thoshte: "O njerëz, jeni në prag të një muaji të madh e të bekuar. Është muaji në të cilin gjendet një natë më e vlefshme se njëmijë muajt. Allahu në ditët e këtij muaji e ka bërë farz agjërimin, kurse netët të kalohen me adhurim nafle. Kushdo që në këtë muajt bën ndonjë punë të mirë, do t'i llogaritet sikur të ketë kryer një farz jashtë Ramazanit. Kushdo që e kryen ndonjë farz gjatë Ramazanit, do t'i llogaritet sikur të ketë kryer 70 farze jashtë tij. Ky është muaji i sabrit (durimit), kurse sevapi për sabrin është Xheneti." Në një hadith tjetër Pejgamberi a.s. ka thënë: "Sikur ta dinin njerëzit se çfarë të mirash sjell Ramazani, do të kishin dëshiruar që i gjithë viti të ishte Ramazan. Në dhjetë ditët e para të këtij muaji Allahu e lëshon rahmetin (mëshirën) e Tij mbi njerëzit, në dhjetë ditët e mesme Allahu ua fal gjynahet robve të Tij, kurse në dhjetë ditët e fundit Ai i fal edhe ata që e kanë merituar dënimin me zjarr xhenemi."

Mehmet Disha



*Ata që u ngritën,
u ngritën më anë të
modestisë*



Detyra e parë e besimtarit është të përpiqet vazhdimisht të forcojë lidhjen e tij me Zotin e Madhëruar. Sepse vlera e robërisë është në përpjesëtim të drejtë me forcën e lidhjes së njeriut me Zotin e tij. Sa më shumë të jemi të lidhur me Të, aq më e fortë është robëria jonë. Në këtë drejtim, zemra duhet të jetë adhuruese e asaj bukurie të përjetshme që nuk shuhet, gjuha duhet ta përmendë Atë gjithmonë, gjymtyrët e tjera duhet të bëjnë gjithmonë vepra që e kënaqin Atë. Nëse zemra, gjuha dhe gjymtyrët janë gjithmonë me Të, atëherë do të bekohemi me shi bereqeti.

Atyre që u janë ngurtësuar zemrat, që u janë mpirë emocionet, që u janë tharë burimet e syve, e kanë shumë të vështirë të mbijetojnë pa u rrëzuar. Prandaj njeriu duhet të jetë hero i "hel' min mezid" (A ka më shumë?) në forcimin e lidhjes së tij me Zotin xh.sh. Me një zemër të pangopur me dashurinë ndaj Tij, vazhdimisht duhet të pyesim "A ka më shumë?" dhe kështu të mundohemi për tu thelluar në rrugën e besimit në Allah, në rrugën e njohjes së Allahut dhe dashurisë ndaj Tij. Çdo gjë që kemi dëgjuar, lexuar dhe dimë për besimin dhe diturinë deri më tani, duhet të merret edhe një herë në konsideratë dhe të thellohemi në to. Sepse ata që qëndrojnë aty ku kanë qenë në fillim dhe i lejojnë vetes të ngecin në vend, pas një farë kohe -Zoti na ruajt- mund të bëhen të paafte për të mbajtur drejtimin e tyre të duhur. Kështu që, ata të cilët nuk përpiqen vazhdimisht për të forcuar marrëdhëniet e tyre me Allahun dhe që nuk përparojnë vazhdimisht drejt Tij, mund të bien pre shumë kollaj nga gjëra kalimtare të kësaj bote.

Arsyja më e madhe pse sot, disa njerëz të humbur po largohen nga besimi, është dobësia e tyre në lidhjen që kanë patur me Zotin. Ashtu siç bëhen inerte objektet që mbeten në vend të palëvizshme dhe nuk mirëmbahen, po ashtu edhe ata që nuk bëjnë përpjekje për t'iu afruar Allahut çdo ditë e më shumë, prishen dhe largohen nga besimi që duhet të kenë ndaj Atij që i ka krijuar. Nëse nuk dëshirojmë të përjetojmë ulje- ngritje të tilla dhe dëshirojmë të vazhdojmë rrugën tonë sipas rrugës së drejtë, duhet të jemi aktiv dita-ditës në forcimin e lidhjes me Allahun e Madhëruar.

Marrëdhënia midis afërsisë me Zotin dhe përlulësisë ndaj Tij

Nga ana tjetër, njeriu që ka bërë përparim në rrugën e adhurimit ndaj Allahut, nuk duhet ta konsiderojë këtë situatë asnjëherë si të mjaftueshme por duhet të kërkojë strehim tek Allahu që të mos bjerë në "uxhb", që do të thotë "vetëkënaqësi" me veten dhe me veprat e tij. Besimtari bëhet i përlulur ndaj Allahut aq sa ai afrohet dhe forcon lidhjen e tij me Të. Pra sa më shumë i përlulur të jetë ndaj Krijuesit të tij, aq më shumë i rritet vlera tek Allahu. Me rritjen e besimit, diturisë dhe dashurisë ndaj Allahut, njeriut i shtohet dashuria dhe entuziazmi për ti treguar robërinë Atij duke qëndruar në këmbë, duke u përkulur, duke bërë sexhde dhe duke u falur. Mirëpo, pavarësisht se çfarë bën në emër të adhurimit dhe bindjes, ai përsëri e di se nuk mund të bëjë mjaftueshëm ndaj robërisë dhe mbetet me mendimet: "O Allah, nuk munda të të njoh siç duhet, nuk munda të të adhuroja siç e meriton, nuk munda të të falenderoj aq sa të takon..." Edhe

pse ai e shfaq adhurimin e tij në praninë e Zotit pesë herë në ditë me përkushtim, ai përsëri e sheh adhurimin e tij si të pamjaftueshëm në krahasim me atë që meriton Allahu. Dhe kështu shpresohet që kjo ndjenjë të plotësojë mangësitë e njeriut ndaj robërisë së mjaftueshme ndaj Allahut.

Zoti e lartëson njeriun që është i vetëdijshëm për vogëlsinë e tij përballë Allahut dhe që ul krahët e tij të përlulësisë në tokë. Një person që mendon se është i madh dhe zhytet në detin e arrogancës do të fundoset gjithnjë e më shumë. Ashtu siç nuk ka cilësi tjetër që e afron njeriun më pranë Zotit përveç përlulësisë, nuk ka asgjë që e largon atë nga Zoti më shumë se sa mendjemadhësia. Siç thotë dhe Profeti Muhamed a.s në një hadith: "Madhështia është atribut specifik që i përket vetëm Allahut."¹ Një person që pretendon këtë cilësi, pavarësisht nëse e kupton apo jo, po pretendon karakteristikën e hyjnisë dhe në këtë kuptim ai po i bën shirk Allahut.

Ashtu si përlulësia dhe modestia janë cilësitë e dalluara të Krenarisë së Njerëzimit a.s, po ashtu edhe katër kalifët pas tij që e ndoqën atë si shembull, arritën majat në përlulësi dhe modesti. Shërbimet e kryera ndaj Islamit gjatë kalifatit të Ebu Bekrit r.a dhe Omerit r.a janë të barabarta me ato të bëra gjatë periudhave të Umajadëve, Abasidëve dhe me ato të kryera nga Perandoria Osmane përgjatë shekujve të tërë. Në 12 vjet pushtet, me lejen e Zotit, ata kanë bërë gjëra që nuk do të arriheshin në 12 shekuj. Por pavarësisht kësaj, Ebu Bekri r.a e sheh veten si një person të falimentuar, të mbetur pa kapital. Ai e vë në dyshim veten dhe ankohet për rebelimin dhe mëkatet e tij. Mjerë për ata që mendojnë se janë diçka!

Ndërsa fisnikët si Ebu Bekri r.a dhe Omeri r.a hapën krahët e tyre të përlulësisë, Allahu i ngriti ata dhe valëviti flamurin e Islamit kudo me duart e tyre. Falë tyre, emri i Zotit dhe i të Dërguarit të Tij valëviteshin si flamur në vende të largëta. Njerëz me kultura dhe kombe të ndryshme u dyndën drejt Islamit.

Po, me të vërtetë që ata ishin të njerëz mëdhenj. Ata e kurorëzuan madhësinë e tyre me përlulësi. Ndërsa arritën kulmin në përlulësinë e tyre, Allahu i ngriti ata lart e më lart.

Për ta përmbyllur me fjalën e dijetarit të epokës sonë i cili thotë: "Ti shpirti im hipokrit! Mos u kreno se i ke shërbyer fesë sepse Allahu e lartëson këtë fe edhe me një - raxhul-u faxhir - njeri mëkatar. Ndoshta ju duhet ta konsideroni veten si ai raxhul-u faxhir -personi mëkatar."² Kush e thotë këtë? E thotë ai i cili është një person që mbajti mbi supë lëvizjen e ringjalljes së një periudhe dhe frymëzoi miliona njerëz me veprat që shkroi. Kjo do të thotë se sa më afër të jetë njeriu me Zotin dhe sa më e fortë të jetë marrëdhënia me Të, aq më e thellë është përlulësia e tij. Detyra e kujtdo që i afrohet Allahut është të zerojë veten. Të mendosh veten si diçka duke u mashtruar nga vlerësimi dhe duartrokitjet e publikut ose pozitat dhe nderimet që përfaqëson do të thotë të hedhësh një hije mbi Qenien Hyjnore. Zoti i Madhëruar na shpërbleftë me modesti dhe përlulësi dhe na mundësoftë arsye që të dimë vendin tone karshi Atij! Amin.

Përktheu Tauland Bica

1. Ebu Davud, libas 27

2. Bediüzzaman, Sözlür, Fjala 26



1

**KRYETARI SPAHIU VIZITË NË PARMA TË ITALISË ME QËLLIM
NDËRTIMIN E NJË XHAMIE**

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, së bashku me Kancelarin dhe Drejtorin e Vakf/Investimeve, zhvilluan një vizitë një ditore në Parma, Itali.

Vizita vjen pas kërkesës së besimtarëve shqiptarë që jetojnë prej vitesh në Parma dhe rrethinat e këtij qyteti për ndërtimin e një xhamie atje.

Kryetari Spahiu zhvilloi një takim me kreun e bashkisë së Parmas, z. Michele Guerra, i cili pasi i uroi mirëseardhjen, i shprehu kryetarit të KMSH-së vullnetin dhe gatishmërinë e tij për të dhënë gjithë ndihmën e nevojshme nga ai personalisht dhe bashkia që drejton për ndërtimin e xhamisë.

Z. Guerra shprehu vlerësim për harmoninë ndërfaqetare që ekziston në Shqipëri dhe u shpreh se diaspora shqiptare e ka jetësuar edhe në Parma këtë cilësi të jashtëzakonshme. Kjo është edhe një nga arsyet që mbështetja e tij ishte e pakushtëzuar në këtë drejtim.

Kryetari Spahiu e falënderoi kreun e Parmas për pritjen, fjalët e mira që ai tha për diasporën shqiptare dhe gatishmërinë për të dhënë ndihmën e nevojshme në ndërtimin e xhamisë.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka marrë përsipër ta ndërtojë këtë xhami për t'iu ardhur në ndihmë besimtarëve të Parmas dhe rrethinave.





2

HERONJTË E RINISË ISLAME, SAHABËT

Në kuadër të ditës kombëtare të rinisë, forumi rinor mysliman shqiptar, organizoi konkursin me temë: "Heronjtë e rinisë islame, sahabët". Ky konkurs bëri bashkë dhjetëra të rinj të cilët prezantuan në formën e esesë, poezisë apo edhe pikturës jetën dhe veprën e shokëve të Profetit Muhamed (a.s.).

Ne ceremoninë e ndarjes së çmimeve fituese, e cila u zhvillua në ambientet e këtij forumi, ishte i pranishëm edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili në fjalën e tij të rastit shprehu vlerësim ndaj kësaj iniciative që në thelb rikujton vlerat e larta të besimit dhe moralit të bukur të sahabëve të nderuar. Në fund të fjalës së tij, kryetari Spahiu i dorëzoi çmimin e parë të këtij konkursi fituesit përkatës.

Më tej, u ndanë edhe çmimet e tjera fituese, çmime të cilat ju dorëzuan të rinjve nga Kryetari i Bordit të Administrimit të Kolegjit Universitar "Bedër", Dr. Ali Zaimi, Drejtori i Medresesë Tiranë, z. Ndrëçim Gjimi, si dhe nga lektorja e Departamentit të Shkencave Islame në Bedër, znj. Rudina Çinari.

Vlen të theksojmë se vlerësimi i punimeve u bë nga juria e ngritur me këtë rast, e cila në bazë të pikëve të grumbulluara për çdo punim, shpalli fituesit e konkursit.





3

INGARKUARI ME PUNË NË AMBASADËN E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË TIRANË VIZITË NË SELINË E KMSH

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim kortezie në selinë e institucionit, të Ngarkuarin me Punë në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, z. David Wisner.

Gjatë bashkëbisedimit, kryetari Spahiu dhe z. Wisner, diskutuan mbi tematika të ndryshme të karakterit fetar, social e kulturor që prekin aktualitetin e vendit tonë.

Në fjalën e tij, z. Wisner, vlerësoi marrëdhënien mjaft pozitive që ka karakterizuar të dy institucionet ndër vite. Më tej, ai theksoi rolin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë si mjaft të rëndësishëm në ruajtjen e harmonisë dhe zhvillimin e dialogut ndërfaqetor në Shqipëri.

Nga ana e tij, kryetari Spahiu, pasi i uroi mirëseardhjen dhe suksese në këtë detyrë të cilën z. Wisner e mori në gusht të këtij viti, e njohu atë shkurtimisht me institucionin e KMSH-së, myftinitë në rrethe dhe institucionet arsimore në varësi.





4

ZHVILLOHET KONFERENCA PËRMBYLLËSE ME TEMË: "100 VJET KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË".

Në kuadër të dhjetëra aktiviteteve të organizuara përgjatë gjithë këtij viti jubile të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ditën e sotme, në ambientet e "Tirana International Hotel" u zhvillua edhe konferenca përmbyllëse me temë: "100 Vjet Komuniteti Mysliman i Shqipërisë".

Të pranishëm në sesionin hapës të kësaj konference shkencore, ishin: Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Reisi Ulema i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, H. Shaqir ef. Fetahu, Kryetar i Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Dr. Ajni Sinani, Përfaqësuesi i Komunitetit Bektashi, Baba Hasani, si dhe studiues, historianë, akademikë, sociologë të shquar, teologë, e besimtarë të shumtë.

Konferenca nisi me leximin e disa ajeteve nga Kurani Famëllartë, të sjella për të pranishmit nga imami i xhamisë Et'hem Bej, z. Elton Karaj.

Për të vijuar më pas me fjalën përshëndetëse të Kryetarit Spahiu, i cili, pasi falenderoi përzemërsisht të pranishmit për pjesëmarrjen, u ndal në një rezumë të shkurtër të rrugëtimit njëqindvjeçar të institucionit, që nga mëvetësimi e deri në ditët e sotme.

Sesioni i përshëndetjeve vijoi më tej me fjalën e H. Shaqir ef. Fetahu, i cili u shpreh i entuziazmuar për pjesëmarrjen në këtë aktivitet jubile të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ku sipas tij, ky institucion në këto 100 vite histori ka qenë shtyllë e fuqishme e harmonisë ndërfetare dhe gjithmonë ka rrezatuar inspirim për të gjithë shqiptarët brenda dhe jashtë shtetit amë.

Të pranishmit në konferencë i përshëndetën gjithashtu edhe Kryetari i Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Dr. Ajni Sinani dhe Përfaqësuesi i Komunitetit Bektashi, Baba Hasani, të cilët ndanë për të pranishmit mesazhe të ndryshme paqeje, solidariteti e bashkëpunimi. Fill pas fjalëve përshëndetëse, filluan punën panelet e referimeve, të përbërë nga personalitete të fushave të ndryshme të cilët trajuan për të pranishmit tematika të ndryshme të rrugëtimit 100-vjeçar të institucionit.



Një panoramë e shkurtër për ringritjen e Komunitetit Mysliman pas përmbysjes së diktaturës komuniste



Nëntori i vitit 1990 do të bënte kthesën e madhe. U shemb muri i Berlinit, filloi lëvizja Demokratike. Në Shqipëri, më 16 Nëntor 1990, u hap xhamia e Plumbit në Shkodër. I burgosur 22 vjet kleriku Hafiz Sabri Koçi, do të bënte thirrjen për përqafimin e fesë nga të gjithë. I sapo liruar nga burgu, u vendos në krye të udhëheqjes së fesë dhe me iniciativën e tij krijuan Shoqatën e Bashkësisë Islame. Ai u zgjodh kryetar dhe dërgoj kërkesën Ministrisë së Drejtësisë për njohjen e shoqatës. Më 23 Janar 1991, Ministria e Drejtësisë miratoi "Bashkimi Islamik Shqiptarë" me program dhe statut, me qendrën në Shkodër.

Një grup nismëtarësh: Ibrahim Balla, Xhavit Ali Mehmeti, Fadil Subashi, Mehmet Sinella, Ramazan Rusheku dhe Faik Kasollja. Pas disa takimesh dhe mbledhjesh me mbështetjen e sekretarit të shtetit për fenë, zotit Bardhyl Fico, u bashkuan edhe intelektualët si Islam Kadesha, Doktor Ndroqi, Iliaz Ali Mehmeti, etj. vendosën që të kërkojnë çelësin e xhamisë nga monumentet e kulturës. Ai që e kishte dorëzuar gjithë arkivin dhe çelësin e xhamisë ishte Ibrahim Balla. Ai shkoi në Komitetin Ekzekutiv dhe kërkoi çelësin e xhamisë. E mori çelësin, por e thirrën në polici, duke e pyetur pse mori iniciativën për të marrë çelësin e xhamisë që e kishte dorëzuar kur ishte drejtor i Vakëfit në Komitetin Mysliman. Më 18 Janar 1991 u bë hapja e xhamisë dhe u organizua një ceremoni madhështore Mevludi.

Sheshi Skënderbeu është i tejmbushur me më shumë se 11000 njerëz të gëzuar për hapjen e xhamisë. Mbas ceremonisë dolën nismëtarët Ibrahim Balla, Fadil Subashi, Shyqyri Bylyku dhe Ramazan Rusheku. Ata u mbajtën mbi kokat e njerëzve deri tek Hotel Tirana pa prekur tokën. Aty u bë mbledhja e parë për tu vendosur së çfarë do të bëhej për të ardhmen e Komunitetit. U vendos që të dërgohej një përfaqësi në Shkodër për të marrë pëlqimin e shoqatës së krijuar "Bashkësia Islame" në Shkodër. U caktua: Bardhyl Fico, Doktor Ndroqi dhe Ramazan Rusheku. U mor mendimi i këshillit të Shkodrës dhe u vendos që bashkërisht të organizohej në një Kuvend të përgjithshëm në Tiranë. Kuvendi u bë më 14 Shkurt 1991. Hafiz Sabri Koçi zgjidhet kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar bashkë me strukturat përkatëse, si dhe Myftinjë të qyteteve apo zonave. Selia e Komunitetit Mysliman vendoset në sheshin Avni Rustemi me miratim nga shteti. Kjo u bë edhe me ndërhyrjen e sekretarit të shtetit për fenë, z. Bardhyl Fico. Këtu roli i Hafiz Sabri Koçit ishte shumë i rëndësishëm. Ai kishte qenë kuadër fetar, myfti që u persekutua dhe u dënua nga regjimi komunist. Sapo doli nga burgu veshi uniformën fetare. Me autoritetin e tij, kulturën e tij dhe me elokuencën e tij në komunikim e predikim, bëri për vete besimtarët kudo. Ai shtriu marrëdhëniet dhe me shtetet fqinje, veçanërisht me Kosovën për të përballuar nevojat që kishte komuniteti në ringritjen e tij. Ndhimuan gjithashtu edhe fondacionet Arabë që ishin në Shqipëri. Më 18.4.1991 u organizua mbledhja e këshillit të përgjithshëm ku ishte i pranishëm

dhe kryetari i Komunitetit Mysliman të Kosovës, z. Rexhep Boja. Këtu bëhet kërkesa edhe për marrjen e godinës së ish-Medresesë së Tiranës që e kishte marrë në përdorim shëndetësia. Aprovohet statuti dhe masat për të ardhmen. Më 15 Maj 1993 bëhet tubimi i përgjithshëm nga i gjithë vëndi i këshillit të përgjithshëm. Këtu u aprovuan strukturat e KMSH, Myftinitë dhe 10 Medresetë në qytete. U morën masa për meremetimin e ndërtimin e xhamive në gjithë qytetet e vendit. Hafiz Sabri Koçi vihet në krye të lëvizjes për kthimin e gjithë pronave të zëna, nga ish-Medreseja, xhamitë, Vakëfe, etj. Ish-Medreseja u lirua pjesërisht në vitin 1995 dhe përfundimisht në 1998. Kryetari i KMSH, H.Sabri Koçi nuk la mbas dore dhe hapjen e Medreseve. Në 10.10.1991 u dërgon Myftinive shkresë për hapjen e 10 Medreseve. Po kështu dhe Medresenë e Tiranës, e cila u vendos në godinën e magazinave pranë xhamisë Kokonozi. Grupi nismëtarë i mësuesve ishin: Ibrahim Balla, Faik Kasollja, Xhemal Balla, Ali Hoxha, Selim Stafa, Mehmet Sinella, që ngarkuan me drejtimin e shkollës Ibrahim Ballën, nën-drejtor Xhemal Ballën, cili më vonë emërohet nga KMSH drejtor i Medresesë së Tiranës.

Mësuesit e parë ishin Medresistët që kishin marrë arsimin e lartë pedagogjik dhe kishin punuar në arsim, nuk kishte asnjë bazë materiale. E sigurova unë në shkollën Fan Noli, mbasi e njihja drejtoreshën nga takimet që bëheshin me drejtorët. Sigurova banka, karrige dhe tabela të zeza, duke kompletuar klasat. Ato kishin defekte të vogla, por me ndihmën e një marangozi besimtar që falej po në këtë xhami, i rregulluam ato. Drejtor arsimit në Komunitetin Mysliman ishte Kujtim Gjinishi, shok i klasës, bashkë me atë morëm dhe miratimin në ministri për të zbatuar programet e gjimnazit, mbasi me këto i jepej mundësi nxënësve që të shkonin në të gjitha degët e fakulteteve. Në këtë kohë Komuniteti Mysliman dërgoj student edhe jashtë shtetit, veçanërisht në Turqi dhe Egjipt. Në vitin 1993, komuniteti më dërgon për specializim në Universitetin e Ezherit në Kairo, Egjipt. Atje takova studentët tanë të cilët më kërkuan për problemin e regjistrimit të tyre në klasë të pestë. U interesova dhe mësova së nuk njiheshin Medreseja jonë pasi nuk kishte programe të lëndëve fetare. Kur mbarova studimet atje, unë bëra të gjitha programet e lëndëve fetare të miratuar nga KMSH, ja dërgoj Universitetit të Ezherit dhe shkolla u njoh, nxënësit u regjistruan në Universitet, të shoqëruar nga unë.

Kuadri mësues i Medresesë që shumë i kualifikuar, i zgjedhur sipas profilit. Nga nxënësit e Medresesë tonë që kanë studiuar jashtë në fakultete fetare dhe civile janë sot kuadro dhe në KMSH. Medreseja ka kryer shumë aktivitete, po më i rëndësishmi përkujtimi i 75-vjetorit të Medresesë së Tiranës në vitin 1998. Sot e kësaj ditë, Medreseja vazhdon me sukses, për të ardhmen e atyre që duan të studiojnë e të zhvillojnë arsimin fetar për breza me radhë.

Xhemal Balla

33 vjet

Nga rihapja e xhamisë
“Et’hem Beu”

Xhamia "Et'hem Beu" në Tiranë i kishte mbyllur dyert e saj për 23 vite me radhë, për shkak të ndalimit të besimit në Shqipëri nga sistemi komunist, i cili u shoqërua me masa të rrepta, me persekutime, burgosje e vrasje të prijësve fetarë që kishin predikuar fenë.

Rihapja e xhamisë "Et'hem Beu" më 18 janar të vitit 1991, u bë me një ceremoni madhështore, në të cilën morën pjesë mijëra besimtarë dhe qytetarë të Tiranës. Ajo ishte dita kur emocionet, entuziazmi shpirtëror dhe shpërthimi i ndjenjave për qytetarët e Tiranës kishin arritur kulmin. Njerëzit të përmalluar, dëgjonin me vëmendje e kureshtje, qanin e çmалleshin me xhaminë.

Shumë nga xhamitë e Tiranës ishin shndërruar ose rrënuar dhe trualli i tyre ishte zëvendësuar me ngrehina të tjera, por, për fatin e mirë, xhamia "Et'hem Beu", e cila bashkë me kullën e sahatit ishin bërë simboli kryeqytetit në çdo imazh fotografie apo pikturë që përfaqësonte Tiranën, arriti t'i shpëtonte tiranisë së komunizmit, që u përpoq të shkatërronte çdo vlerë të besimit. Ishte prej begatave të Zotit, që kjo xhami qëndroi në këmbë gjersa u rihap sërish për t'iu rikthyer zemrave të besimtarëve.

Ceremonia filloi me thirrjen e ezanit të parë nga Fadil Subashi. Ishin Xhavit e Iljaz Alimehmeti, Ramazan Rusheku, Ibrahim Balla, Mehmet Sinella, etj., disa nga nismëtarët kryesorë myslimanë, të cilët hapën në Tiranë dyert e xhamisë "Et'hem Beu" për besimtarët. Përmbajtja e fjalimeve të tyre në xhami, mund të përmbledhet në thirrjen e njerëzimit për besim, paqe, dashuri, harmoni, mirëkuptim, bashkëpunim, miqësi e vëllazërim midis njerëzve pa dallim.

Atë të premte janari, për qytetarët e Tiranës kishte zbardhur një ditë e madhe, që do të ringjallte shpresën për ditë më të mira. Në fytyrat e pjesëmarrësve lexohej gëzimi për këtë ngjarje të madhe, që shënonte rikthimin e besimit në jetën e tyre, pas një diktature të shfrenuar dhe një regjimi të ashpër komunist, i cili u përpoq të çrrënjosë fenë dhe besimin, por që kurrë nuk ia doli mbanë. Edhe pse përjetuan 23 vjet ngricë shpirtërore, shumë qytetarë të Tiranës, kishin ruajtur brenda tyre dashurinë për Zotin, kishin ruajtur ndezur brenda shpirtit të tyre një zjarr, që nuk lejoi ngricën komuniste të ftohte besimin e tyre në Zot. Kjo gjë, u vërtetua pikërisht në këtë ditë.

Lidhur me fillimet e aktivitetit fetar në qytetin e Tiranës z. Islam Kadesha shkruan: "Me rekomandimin e z. Sinan Tafaj, shkuam në shtëpi të z. Faik Kasollja, i cili na mirëpriti dhe lamë takimet e para në lulishten pranë Kuvendit Popullor. Në takimin e dytë, z. Faik solli kolegë dhe miq të tjerë, zotërinjtë Ramazan Rysheku, Ibrahim Balla, Xhavid Alimehmeti, Selim Stafa e Mehmet Sinella. Gjatë dhjetorit 1990, të ngarkuar me plot ngjarje, u zhvilluan takime pas takimesh. Në fillim të vitit 1991, z. Iljaz Alimehmeti vuri në dispozicion banesën e vet për të zhvilluar takimet. Në ato ditë, një kontribut ka dhënë edhe një palestinez me emrin Zyher Naim. Në takimet e

fillim vitit 1991, morën pjesë edhe besimtarë të tjerë si dr. Shefqet Ndroqi, dr. Qazim Bakalli, Bardhyl Fico, Sali Mëniku, Kujtim Gjinishi, Shyqyri Bylyku, etj. Pas shumë takimesh, arritëm në përfundimin që të konkretizohej e gjithë puna me marrjen e xhamisë "Haxhi Et'hem Beu", detyrë që iu ngarkua Islam Kadeshës, Iljaz Alimehmetit, Ramazan Ryshekut dhe Ibrahim Ballës. Me gjithë pengesat e kryesisë së pushtetit të atëhershëm, drejtori i Institutit të Monumenteve të Kulturës, z. Emin Riza, u tregua i gatshëm në dhënien e xhamisë më 15.01.1991. Me datë 16.01.1991 komisioni provizor, i përbërë prej 7-8 vetash, pasi mori në posedim xhaminë e "Haxhi Et'hem Beut", mori vendim që me datë 18.01.1991 të deklaronte rihapjen e veprimtarisë fetare. Në mbledhjen e fundit të komisionit u vendos të mbahej fjala e rastit nga z. Ibrahim Balla, të bëhej drejtimi i mevludit nga z. Ramazan Rysheku dhe të bëhej falja e parë e namazit të ditës së premte. Kjo ka qenë ceremonia e parë, tepër madhështore, në të cilën morën pjesë me mijëra qytetarë, nga të cilët u mbulua i gjithë sheshi "Skënderbej". Ka qenë një ceremoni tepër prekëse, sepse për gati 50 vjet nuk ishte parë ndonjëherë një pjesëmarrje e tillë. Data 18 janar 1991, është dita e parë që zyrtarisht konsiderohet rihapja e veprimtarisë fetare në Tiranë."¹

Ndërsa në një bisedë, ish drejtori dhe mësuesi i Medresesë së Tiranës, z. Xhemal Balla, lidhur me këtë ditë, thotë: "Në Tiranë, mbështetja e parë ishte e z. Ibrahim Balla, ish-drejtor i përgjithshëm i vakfrit në Komunitetin Mysliman Shqiptar deri në vitin 1967, kur shteti e mbylli fenë me ligj. Ai ishte i fundit që dorëzoi arkivin e Komunitetit Mysliman, si dhe çelësin e xhamisë së 'Et'hem Beut' në Komitetin Ekzekutiv të Tiranës, sot Bashkia e Tiranës. Hapi i parë u hodh në mbajtjen e një ceremonie fetare (mevlud) në xhaminë e 'Et'hem Beut' më 18 janar 1991. Ishte Ibrahim Balla ai që kishte dokumentin e dorëzimit të çelësit në Komitetin Ekzekutiv të Tiranës më parë, i cili e rimori çelësin me vështirësi dhe me rezistencë nga Bashkia. Ceremonia kaloi në mënyrë të përsosur, e ndjekur nga mijëra besimtarë në sheshin 'Skënderbej'. Pas ceremonisë së mevludit, zotërinjtë Ibrahim Balla, Ramazan Rusheku e të tjerë, u drejtuan drejt 15-katëshit (Hotel Tirana). Këtu bëhet mbledhja e parë zyrtare bashkë me z. Bardhyl Fico."

Vlerësim dhe mirënjohje për të gjithë ata njerëz, që me zell e përkushtim kontribuan në skalitjen e datës 18 Janar 1991 në kujtesën historike të Tiranës, si dita e rihapjes së xhamisë "Et'hem Beu".

Dorian Demetja

1. Islam Kadesha, Rihapja e institucioneve fetare me 18.01.1991, gazeta "Drita Islame", nr. 3 (158), viti VIII i botimit, shkurt 1999.

Disa specifika rreth guslit të grate II



Farzet e guslit

Gusli është: "Larja e të gjithë trupit në një mënyrë të veçantë". Gusli është bërë detyrim nëpërmjet një ajeti Kur'anor ku thuhet:

اورَهَطَّافَ ابْنُ مَجْمُوحٍ مَثْنُكَ نِاَوُ

"Nëse jeni të papastër (si pasojë e marrëdhënieve bashkëshortore) pastrohuni (duke u larë krejtësisht)."

Sipas medh'hebit Hanefi, farzet e guslit janë tre:

- 1-Larja e gojës tre herë duke bërë gargarë.
- 2-Larja e hundës tre herë duke e tërhequr ujin deri sa hunda të ndjejë djegie të lehtë brenda saj.
- 3-Larja e të gjithë trupit në një mënyrë që mos të mbesë në të asnjë pjesë e thatë.

Farzet e guslit sipas medh'hebit Shafii gjithashtu janë tre:

- 1-Nijeti (qëllimi i thënë me gojë dhe me zemër).
- 2-Pastrimi i papastërtisë që gjendet në trup (nëse ka).
- 3-Larja e të gjithë trupit.

Dobitë e guslit janë të shumta por këtu mund të përmendim njërin prej tyre. Gusli i marrë pas kryerjes së marrëdhënieve bashkëshortore, i përfton trupit një energji të re, rifreskim, i stabilizon qarkullimin e gjakut dhe e përgatit njeriun për një atmosferë adhurimi.

Si merret gusli?

Në fillim i gjithë trupi laget me ujë. Më pas pastrohen papastërtitë dhe pastrohen vendet si kërthiza dhe organet intime. Pas këtyre, merret abdest normal si abdesti për namaz dhe në fund lahet i gjithë trupi duke e fërkuar, për të mos mbetur asnjë pjesë e pa lagur. Duhet patur parasysh që gjatë marrjes së guslit nuk duhet shpërdoruar uji. Për këtë arsye këshillohet që të merret gusl me ujin e përgatitur në kovë e jo me ujin që del nga çezma. Edhe nëse përdoret çezma, në këtë rast këshillohet që ajo të mos jetë e hapur në maksimum sa që të jetë i vështirë kontrolli i ujit dhe të mundësojë shpërdorimin e tij. Gjithashtu gjatë marrjes së guslit është shumë i rëndësishëm fërkimi i trupit. Sipas jurisprudencës Maliki, fërkimi i lëkurës së trupit gjatë marrjes së guslit, është farz. Megjithëse në jurisprudencën tonë

Hanefi, fërkimi i trupit nuk cilësohet ndër farzet, pikëpamja e jurisprudencës Maliki, duhet të na ngjalli në brendësinë tonë ndjenjën se ky qenka një fakt i rëndësishëm dhe duhet ta kemi parasysh edhe ne gjatë guslit.

A është e nevojshme që flokët e lidhura gershet të zgjidhen kur merret gusli?

Nëse një grua në momentin që është bërë për të marrë gusl, i ka patur flokët gërshet dhe e ka të vështirë t'i zgjidhi ato, atëherë për të mos e vështirësuar atë është e mjaftueshme vetëm larja e flokëve duke depërtuar në mënyrë natyrale deri tek rrënjët në lëkurë. Në të kundërt, nëse uji nuk depërton dot deri në lëkurë, atëherë flokët duhet të zgjidhen. Por, nëse gruaja nuk i ka flokët gershet, në këtë rast ajo e ka farz (detyrim) larjen e të gjithë flokut deri në rrënjë ashtu siç është. Nëse gruaja ka një arsye tjetër që nuk mund t'i zgjidhë flokët

apo nuk mundet dot ta lajë kokën me ujë, për shembull në qoftë se ka një plagë, atëherë mundet vetëm të fërkojë kokën me dorën e lagur, pra të bëjë mes' h mbi flokët.

A duhen larë vrimëzat e shpuara nga vathët?

Praktikisht pas heqjes së vathëve nga veshët është e mjaftueshme vetëm spërkatja me ujë e vrimëzave dhe fërkimi me dorë i tyre, pa hyrë në vështirësi të tjera si, futja e një gjilpëre mes vendit të shpuar etj. Nëse vrimëzat e hapura, me kalimin e kohës janë mbyllur, atëherë nuk ka më nevojë për një larje të tillë.

A prihen thonjtë gjatë gjendjes xhunub?

Si fillim duhet të theksojmë se prerja e thonjve në gjendjen xhunub, nuk është haram (e ndaluar) pasi për këtë nuk ka asnjë argument kur'anor apo profetik. Ndërsa imam Gazaliu e ka trajtuar këtë pjesë më me kujdes duke vendosur pikëpamjen e tij se, meqënëse në ditën e gjykimit njeriu do të ringjallet edhe me trup dhe çdo pjesë që ka prerë nga trupi në këtë botë do t'i ribashkohet në botën tjetër, arrin në përfundimin se ky veprim por edhe heqja e qimeve në këtë gjendje, janë mekruh.

Këtu nuk duhet harruar se harku kohor i lejuar për të mos prerë thonjtë e qimet, është deri në 40 (dyzetë) ditë, pra një njeri nuk mund të qëndrojë pa prerë qimet e thonjtë më shumë se dyzetë ditë. Nëse gjendja xhunub e mashkullit apo gjendjet e veçanta të femrës, rastisin me ditët e fundit të këtij dyzetë ditëshi dhe pritja e mbarimit të këtyre gjendjeve ka rrezik tejkalimin e normës së lejuar 40 ditë, atëherë zgjidhet rruga "e keqja më e vogël" dhe qimet prihen në gjendje xhunubi.

Për gratë këshillohet që ta kontrollojnë veten e tyre para së t'u vijnë periudhat e veçanta. Nëse ka diçka për të prerë nga trupi, e mira është që mos të lihen për në ditët kur janë në gjendjet e tyre të veçanta.

A nevojitet gusl pas kontrollit të shtatzënësisë tek mjekja?

Nëse bëhet kontroll gjinekologjik me gishta apo sende të tjera normalisht nuk është rast që

kërkon gusl. Pra gjatë vizitës tek doktoresha përkatëse, nëse me vendosjen e aparaturës femra nuk ndjen kënaqësi nuk nevojitet gusul, por, nëse ndjen atëherë nevojitet të marrë gusul.

A lejohet ngrënia dhe pirja para marrjes së guslit?

Është mendub që një njeri në gjendjen xhunub, si fillim të marrë abdest normal dhe më pas të hajë e të pijë diçka. Nëse nuk merr abdest normal, mund të lajë duart dhe të shpërlajë gojën. Nëse nuk e bën as këtë, ka kryer një veprim mekruh. Për femrat të cilat ndodhen në periudhat e tyre të veçanta nuk ka një kusht të tillë por sugjerohet larja e duarve para ushqimit apo gatimit. Në fund të fundit, larja e duarve para dhe pas ushqimit edhe në kohët normale është nga sunetet e Profetit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).

Tregu i Medines

Tregtia është e vjetër po aq sa njerëzimi, me anë të saj njerëzit kanë plotësuar nevojat e ndryshme, kanë fituar para, kanë komunikuar me njeri-tjetrin. Islami në shumë vende të botës është përhapur me anë të tregtarëve të drejtë myslimanë. Shpeshherë tregtia është përdorur edhe si mjet për të shtrirë influencat dhe për të ndikuar politikisht tek shtetet e tjera. Dihet tashmë se pavarësia ekonomike luan rol jetik për pavarësinë politike.

Kur myslimanët emigruan në Medine, qyteti kishte një popullsi prej 10 mijë banorësh, 4 mijë ishin hebrenj, ndërsa 6 mijë ishin arabë. Në përgjithësi ekonomia dhe tregu i Medines dominohej nga fiset hebreje, ndërsa arabët kishin një ndikim shumë të vogël në këtë treg.

Profeti (a.s.) që në rininë e tij është marrë me tregti, ka shkuar në Palestinë, Siri dhe Jemen bashkë me hxaxhain e tij Ebu Talibin. Gjithashtu gjatë periudhës së Mekës dhe sidomos gjatë periudhës së Bojkotit i cili zgjati 3 vjet, është përballur me ambargo të fortë ekonomike. Të gjitha keto eksperiencia ja diktuan Profetit (a.s.) që pas themelimit të shtetit Islam, të kontrollonte ekonominë dhe të ndërtonte një treg, që funksiononte në bazë të rregullave islame dhe dominohej nga myslimanët. Në këtë mënyrë do të fitonte pavarësi ekonomike dhe nuk do t'i cenohej edhe pavarësia politike e shtetit të sapo formuar. Themelimi i "Tregut të Medinës", ka qenë njëri nga hapat më të rëndësishme që Profeti (a.s.) ka bërë për të konsoliduar shtetin e ri Islam.

Tregu që egzistonte në Medine dominohej nga fiset hebreje dhe siç thamë, arabët kishin një ndikim shumë të vogël. Fiset Hebreje që dominonin tregun ishin 3: Beni Kaynuka që merrej me tregtinë e floririt, jepte para me fajde etj...; Beni Nadr, që më së shumti merrej me bujqësi, prodhonte dhe shiste hurma; Beni Kurajdha, të cilët ishin lëkurpunues, prodhonin dhe shisnin shapka, çizme, dhe mjete të tjera të bëra nga lëkura.

Duke qenë së hebrejnte e sundonin tregun, gjithashtu ata vendosnin dhe rregullat e tregut, caktonin çmimet

e produkteve etj.

I përballur me këtë realitet, Profeti (a.s.) e pa të nevojshme që të ndërtojë një treg alternativ. Si hap i parë u ndërtua një treg i vogël pranë tregut të hebrenjve. Myslmanët filluan të bënin tregti në këtë Pazar, i cili u bë i famshëm në një kohë të shkurtër. Fillimisht hebrenjtë u habitën për situatën e re të krijuar, më pas filluan ta hetonin fshehurazi tregun e ri, e më pas të frikësuar se monopoli i tregtisë që kishin ndërtuar në Medinë do t'u dilte nga duart, vendosën që ta shembnin atë. Duke përfituar nga errësira e natës, Kab bin Eshref bashkë me njerëzit e tij, e shkatërruan çadrën që kishte ndërtuar Profeti (a.s.), duke shkatërruar kështu edhe tregun e parë të myslimanëve. Kur u zgjuan në mëngjes, myslimanët u përballën me tregun e shkatërruar, të gjithë ishin të inatosur, vetëm Profeti (a.s.) po buzëqeshte. Kur e pyetën për arsyen e buzëqeshjes ai tha: "Puna që bëmë i inatosi hebrenjtë, do të thotë se jemi në rrugën e duhur. Këtë herë do ta ndërtoj tregun në një vend të tillë që do të inatosen edhe më shumë." Pas kësaj ngjarjeje Profeti (a.s.) bleu një tokë të gjerë në vendin ku kishin qenë varrezat e vjetra të qytetit, ndërtoi aty tregun dhe e la vakëf për myslimanët deri në ditën e gjykimit.

Ky treg do të njihej si "Tregu i Medines" dhe u ndërtua në zonën e Benu Saides, kishte hapësirë të gjerë për njerëzit që lidhnin devetë, të cilat ishin mjete kryesor i transportit në atë kohë, e kështumund ta kontrollonin kollaj vendodhjen e saj, gjithashtu ishte dhe pranë varrezave, kjo shërbente si përkujtim ditor për myslimanët që të mos mashtroheshin nga përfitimet kalimtare të kësaj bote dhe të fitonin pasuri me anë të mashtrimit dhe rrugëve haram. Në këtë treg u vendosën rregulla të reja, të cilat siguronin funksionimin e mbarë të tij.

Rregullat që Profeti (a.s.) vendosi në këtë treg vijojnë si më poshtë:

a-) Ndaloj që shitesit të kishin një vend të caktuar në treg; hoqi taksën e tregut. Në këtë mënyrë Profeti

(a.s.) parandaloi monopolin, kështu që kush vinte herët në mëngjes zinte vendin më të mirë, kishte mundësi që të shiste më shumë. Në të njëjtën kohë u zgjatën dhe oraret e punës, sepse tregtarët shkonin herët në treg për të zënë pozicionin më të volitshëm. Gjithashtu në atë kohë tregtarët paguanin taksë për vendin që zinin në treg, taksë e cila pasqyrohej tek çmimet. Profeti (a.s.) e hoqi këtë taksë, praktikë e cila ndikoi në uljen e çmimeve dhe rrjedhimisht shtimin e klientëve që vizitonin tregun.

b-) Ndaloi të gjithat format e kamatës në treg. Në atë kohë një pjesë e mirë e tregtisë ishte e ndërtuar mbi kamatën. Sistemi i kamatës përdorej nga të pasurit për të shfrytëzuar të varfërit, sistem i cili fatkeqësisht vazhdon edhe sot. Kamata e zhyt borxhliun edhe më thellë në krizë ekonomike, rastet kur borxhliu arrin që të nxjerrë fitim nga borxhi i marrë me kamatë janë shumë të rralla, ndërsa kamatëdhënësi nuk rrezikon, nuk prodhon, nuk ofron produkt por vetëm fiton dhe pasurohet vazhdimisht. Islami e ndaloi këtë lloj praktikë dhe çdo formë tjetër të kamatës, ndalesë e cila u zbatua me përpikëri edhe në Tregun e Medines.

3-) Ndaloi grumbullimin e mallit me qëllimin e manipulimit të tregut. Tregtarët e fuqishëm e mblidhnin të gjithë mallin në treg dhe më pas e shisnin me çmime shumë të larta. Gjë e cila dëmton dhe tregtarët edhe klientët e tjerë. Profeti (a.s) me anë të këshillave dhe kontrollit i dha fund kësaj praktikë të dëmshme.

4-) Ndaloi konkurrencën e padrejtë. Në atë kohë tregtarët ose sekserët, i prisnin fshatarët në hyrje të qytetit, ua blenin të gjithë mallin me çmim të lirë, sepse fshatarit nuk ishte i vetëdijshëm për çmimin e vërtetë të mallit, dhe më pas këtë mall e shisnin më shtrenjt në treg. Profeti (a.s.) e ndaloi këtë praktikë e cila e dëmtonte prodhuesin, duke thënë: *“Lejini që të vijnë në treg, të shikojnë çmimin e mallrave dhe pastaj jepuni ofertë tuaj për ta blerë mallin.”*

Ai gjithashtu ndaloi të shitej malli që nuk ishte në posedimin e tregtarit, ndaloi blerjen dhe shitjen e mallit kuturu (pa e patur mallin prezent) pa e peshuar dhe numëruar, ndaloi shitjen e hurmës së njomë në pemë duke e hamendësuar sasinë ekuivalente me atë të hurmave të thata, ndaloi mashtrimin që bëheshin më kafshët që silleshin në treg dhe nuk u mjelej qumështi dy-tre ditë që të dukeshin me gjinj të mëdhenj etj.

5-) Ndaloi shkëmbimin e mallit me mall tjetër (Kliringun). Në këtë praktikë, njëri prej shkëmbyesve të mallit do të dëmtohet, sepse është e pamundur që të shkëmbesh dy mallra të ndryshëm me të njëjtën vlerë. Ai thotë: “Në qoftë se janë dy mallra që do të shkëmben, fillimisht caktohet çmimi i njërit dhe shitet, pastaj caktohet çmimi i tjetrit dhe blihet.” Në këtë mënyrë të dy mallrat shkëmben me vlerën e tyre reale.

6-) Ndaloi ndërhyrjen e shtetit në caktimin e çmimeve. Kjo praktikë dëmton prodhuesin, tregtarin dhe klientin. Profeti (a.s.) e la të lirë tregun, kështu që çmimin e

produkteve e rregullonte vlera e produktit, sasia e tij, dhe kërkesa që kishin klientët për të.

Profeti (a.s.) nuk u mjaftua vetëm me vendosjen e rregullave por gjithashtu caktoi dhe zyrtarë të cilët kontrollonin dhe menaxhonin tregun. Fillimisht këtë detyrë e mbajti Omeri (r.a.) me pas Abdullah bin Said, madje kanë qenë edhe dy sahabe gra që punonin dhe kontrollonin tregun, Shifa bin Abdullah dhe Semra bin Nuhejk. Detyrat e këtyre nëpunësve ishin si më poshtë:

1-) Siguronin qetësinë dhe rregullin në treg, pengonin vendosjen e mallrave në rrugë, gjë e cila sillte vështirësi në lëvizje, madje Profeti (a.s.) pati caktuar edhe gjerësinë që duhet të kishin rrugët, duhej të ishin aq të gjëra sa të mund të kalonin lirshëm dy deve të ngarkuara me mall.

2-) Parandalonin manipulimin e çmimeve, me anë të grosimit.

3-) Kontrollonin cilësinë e mallrave dhe parandalonin mashtrimet që mund të bëhej me mallin. Madje Profeti (a.s.) ka marrë pjesë në të tilla kontrole. Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: “Në një rast, ndërsa i dërguari i Allahut (a.s.) ishte në treg, kaloi afër një tregtari që shiste drithë. Kur e futi dorën në të, atij iu njomën gishtat (nga lagështira). Ai tha: “O pronar i ushqimit, çfarë është kjo?” Pronari tha: “O i Dërguar i Allahut, e ka zënë shiu (ushqimin).” Ai i thotë: “Po t’i kishe vënë (të njomat) mbi ushqim, që ta shohin njerëzit.” Pastaj tha: “Nuk është prej nesh ai që na tradhton.” (Shënon Muslimi dhe Tirmidhiu)

4-) Kontrollonin peshoret që të mos bëheshin mashtrime në peshimin e mallit. Veprim të cilin Allahu e ka ndaluar në Kur’an. Allahu i Lartësuar e ka ndaluar këtë në Kur’anin Famëlartë duke thënë “Të mjerët ata që peshojnë! Ata që kur matin prej njerëzve, për vete e plotësojnë, e kur u matin ose u peshojnë të tjerëve, u lënë mangët.” (Mutaffin, 1-3)

5-) Ndalonin betimet e shpeshta dhe të kota që bënin njerëzit gjatë tregtisë. Profeti (a.s.) ka thënë: “Kini kujdes ndaj betimit të shpeshtë gjatë shitjes, për shkak se ai e shton tregtinë, pastaj e çrrënjos bereqetin.” (Shënon Muslimi)

6-) Ndalonin shitjen e mallrave që ishin të ndaluara fetarisht, si alkolin, mishin e derrit etj.

Këto rregulla të reja bënë që Tregu i Medines të kthehej në pikë tërheqëse për tregtarët dhe ta linte në hije tregun që dominohej nga hebrenjtë.

Po ta analizojmë me kujdes shembullin e Profetit (a.s.) do të konstatojmë pikat kryesore që sigurojnë sukses në tregti. Ai (a.s.) e arriti suksesin duke dhënë alternativë, nuk përdori fuqinë e shtetit për të mbyllur tregun e vjetër që dominohej nga hebrenjtë, por ndërtoi një alternativë më të mirë. Një treg që ofronte produktet cilësore, çmime konkurruese, ambient komod, siguri nga çdo lloj forme mashtrimi etj.

Erjol Haxhiu

Lutja,
**një kandil ndriçues
në errësirën e kësaj
bote**

Njeriu. Qenia më e lartë dhe më e përsosur që Zoti ka krijuar. Jeta e tij është një rrugëtim i gjatë, plot sfida duke kaluar errësirat e kësaj bote drejt qëllimeve më të larta dhe përsosjes së vetes së tij. Njeriu është dërguar në këtë botë për të njohur Zotin, krijuesin e tij. Për të njohur Zotin ai duhet ti nënshtrohet dhe adhurojë atë ku thelbi i çdo adhurimi është lutja. Lutja mund të jetë një thirrje, kërkesë, dëshirë apo një rënkim i zemrës me anë të së cilës njeriu i shpreh gjendjen Zotit tij të Mëshirshëm dhe Fuqiplote. Por në thelb ajo është një thirrje nëpërmjet së cilës njeriu shpreh edhe njëherë robërinë, nënshttrimin dhe besnikërinë ndaj Zotit të tij.

Çdo gjë univers është krijuar me aftësi dhe detyra të caktuara e privuar nga vullneti i lirë dhe fuqia për të zgjedhur. Njeriu, si krijesa më e lartë, është pajisur me vullnetin e lirë, intelektin dhe potencialin për të sunduar mbi krijesat e tjera dhe kuptuar e njohur thelbin e gjërave. Në anën tjetër, në natyrën e tij ai është një qenie e dobët dhe e pafuqishme përballë rreziqeve, fatkeqësive dhe të panjohurave që i kanosen në këtë botë. Njeriu ka shumë nevoja të cilat asnjëherë nuk arrin ti plotësojë me fuqinë e tij dhe shumë dëshira të pafundme që dora e tij nuk arrin ti marre ato. Rrjedhimisht, nevoja për tu mbështetur te dikush më i fuqishëm dhe për ti kërkuar ndihmë në çdo moment të jetës është një aspekt thelbësor i rrënjësor thellë në natyrën e tij. Kështu lutja përbën një nevojë themelore për qenien e njeriut dhe një dimension që i jep kuptim dhe vlerë jetës së tij në këtë botë. Nëpërmjet saj, çdo moment i jetës merr një dimension shpirtëror dhe të mbinatyrshëm përtej nivelit material, njerëzor dhe ligjeve natyrore ku njeriu ndjen praninë dhe udhërrëfimin e Zotit në çdo moment të jetës së tij.

Lutja është një gjendje që përfshin të gjithë qenien e njeriut në të gjitha dimensionet e saj. Njeriu duke ndjerë nevojën për Zotin në shpirtin e tij, lutet e përgjërohet me fjalë dhe përpiket ti realizojë dëshirat në jetën e tij. Në botën moderne, si rrjedhojë e sekularizimit të perceptimit të njeriut mbi natyrën e tij, këto dimensione gjenden të ndara midis hyjnizimit të punës e fuqive të njeriut dhe largimit nga përpjekja për të ndryshuar në emër të fetarizmit dhe besimit te Zoti. Kështu lutja si një ndjesi që përfshin shpirtin dhe shprehet me fjalë ndaj Krijuesit nuk është projektion i mendjes së njeriut apo një mënyrë për t'ju shmangur përpjekjes me anë të vullnetit të tij. Përkundrazi, po të shikojmë lutjet që kemi mësuar nga Profeti Muhamed a.s për çdo moment të jetës sonë, janë një frymëzim dhe udhërrëfim që njeriu të përpiket të realizojë kërkesat dhe plotësojë nevojat e tij duke u mbështetur te Zoti dhe Fuqia e Tij. Për më tepër, lutja dhe komunikimi me Zotin tonë është një nevojë thelbësore që njeriu të reflektojë, gjallërojë dhe ndryshojë botën e brendshme të tij si e vetmja mënyrë për të ndryshuar sado pak botën përreth tij.

Lutja është një strehë e ngrohtë që i dhuron njeriut siguri e qetësi në këtë botë. Nëse Zoti i ka dhënë atij dëshirën për të kërkuar atëherë ai do ti përgjigjet robit të tij për çdo gjë që ka për të kërkuar. Njeriu lutet, kërkon prej Zotit në çdo moment të jetës e Ai i dhuron gjithmonë atë që është më e mirë dhe e dobishme për njeriun edhe pse mendja e tij, e kufizuar në dimensionet e kësaj bote nuk arrin ti kuptojë fshehtësitë e qiellit. Ajo çka e mundon njeriun që përpiket të ndjejë praninë e Zotit me anë të lutjes në këtë jetë është se sa shumë kemi nevojë për Zotin, për të trokitur në derën e tij të Mëshirës dhe Bujarisë dhe sa pak lutemi e kërkojmë prej Tij.

Çdo moment që na lumturon apo na sjell mërzi e hidhërim në jetën tonë është një mundësi dhe frymëzim për t'ju drejtuar Zotit dhe për t'ju lutur Atij. Kështu dëshira dhe zelli i njeriut për tu lutur në vetvete është një bekim tjetër prej Zotit për robin e tij, ku shpirti i tij shuan edhe një herë etjen duke ndjerë pafundësinë e Mëshirës Hyjnore në jetën e tij të kësaj bote. Në anën tjetër, braktisja e lutjes është shenjë e besimit të tepërt te vetja, te përpjekja e tij dhe pritja e suksesit prej të tjerëve e jo prej Zotit. Për më tepër, refuzimi për tu lutur dhe përulur ndaj Zotit e çon njeriut drejt hyjnizimit të egos dhe rebelimit kundrejt Madhështisë së tij që e fundos njeriun në errësirën e pafund të mosbesimit.

Lutja është një moment vetmie, në errësirën e plotë të një nate kur njeriu flet me Zotin e tij i cili është më i afërt me të se çdo gjë dhe ka Fuqi mbi gjithçka. Ajo është një moment freskie dhe rigjallërimi për shpirtin e tij të burgosur në këtë botë materiale dhe një çast reflektimi për mendjen me anë të së cilës njeriu kthehet te vetvetja për ripërtëritje edhe një herë marrëdhënien me Zotin e tij. Kështu për njeriun ajo duhet të jetë një gjendje që duhet ta shoqërojë vazhdimisht në mënyrë që të reflektojë Përkujdesjen Hyjnore në jetën e tij.

Lutja është një thirrje plot përulësi dhe respekt para Madhështisë së Krijuesit e mbushur me shpresë dhe besim për realizimin e saj. Përvuajtja gjatë lutjes është gjendja më e lartë e shpirtit që tërheq Ndihmën dhe Mëshirën hyjnore në botën tonë njerëzore. Forma më e lartë e lutjes dhe komunikimit me Zotin gjendet në lutjet Profetit tonë dhe njerëzve e dashur të Zotit që kanë jetuar përgjatë historisë. Ato janë fjalët më të larta të cilat rrjedhin prej shpirtit të pastër që kanë reflektuar njohjen e Zotit dhe kanë arritur majat e smeralda të zemrës. Në atmosferën e tyre komunikimi i njeriut me Zotin merr një kuptim dhe vlerë të veçantë e nëpërmjet tyre gjen rrugën e përjetimit të bukurive edhe thellësive të një shpirti të shkëputur prej materies, drejt thelbit dhe zanafillës së saj.

Abdullah Bulku

Nata e mirë Regaib

Regaib në gjuhën arabe është shumësi i fjalës "ragibe", që do të thotë se kjo është nata e dhuntive, dhuratave, shpërblimeve dhe nxitëse për vepra të mira. Këtë vit, më datë 27.02.2020, kaloi nata e mirë e parë Regaib.


Nata e mirë Regaib, sipas kalendarit hënor, bie natën e xhumasë së parë (nata që lidh ditën e enjte me të premte) të muajit Rexhep, i cili është edhe muaji i parë i Tre Muajve të mirë. Çdo natë e xhuma është e bekuar. Kur këto dy netë puqen bashkë nata bëhet akoma më e bekuar dhe më e dobishme. Me vlerat e mëdha që përmban kjo natë, është njëkohësisht sihariqi dhe lajmëtari i parë i muajit të Ramazanit. Në aspektin psikologjik kjo është shumë e rëndësishme, sepse besimtari hyn në një parapërgatitje shpirtërore dhe e drejton veten e

tij kah adhurimeve, përgjegjësi individuale dhe familjare duke urdhëruar të mirën e duke ndaluar të keqen.

Në popull është konceptuar gabim fakti që në këtë natë ka mbetur shtatëzanë nëna e profetit tonë, Emineja. Vetë data e lindjes së profetit tonë nuk e vërteton këtë hipotezë. Mundet që në këtë natë Emineja ta ketë kuptuar që ishte shtatëzanë. Një komentim i tillë i këtij koncepti do të ishte më i përshtatshëm.

Sipas mendimeve të dijetarëve Islam, në këtë natë Allahu i madhëruar e ka begatuar profetin Muhamed (s.a.s.) me dhunti dhe dhurata shpirtërore shumë të çmuara. Edhe profeti ynë i dashur e ka lavdëruar dhe falenderuar Allahun (xh.sh.) me lutje, teube dhe namaz.

Allahu natën e Regaibit i jep muslimanëve



mirësi dhe begati të panumërta. Kjo është nata kur pranohen lutjet, pendesat dhe kur shpërblimet e adhurimeve janë të mëdha e të shumta. Profeti ynë i nderuar, në një hadith të transmetuar nga Enesi (r.a.) thotë: "Kujdes, përpigu të rrish zgjuar natën e xhumasë së parë të muajit Rexhep, të mos e kalosh atë në shkujdesje, sepse engjëjt asaj nate ia kanë vënë emrin Regaib!" Ndërsa në disa thënie të tjera për rëndësinë e kësaj nate Profeti Muhamed (s.a.s.) thotë: "Ai që e vlerëson natën e xhumasë së parë të muajit Rexhep (Nata e Regaibit), Allahu i madhëruar nuk e dënon në varr" (Saadet-i Ebedije). "Lutja që bëhet në këto pesë netë nuk kthehet mbrapsht: Në natën e Regaibit, natën e 15 të Shabanit, të Xhumanë, natën e Bajramit të Ramazanit dhe të Kurbanit" (Ibn-i Asakir).

Si përfundim themi që kjo natë duhet vlerësuar nga besimtarët me namaz, me lexim Kur'ani, me teube istigfar, i dërgohen salavate Profetit, dita e enjte agjërohet dhe në darkë kryhen adhurime të llojeve të ndryshme, gjithashtu, kjo natë kalohet edhe me punë të tjera të dobishme dhe sevappurëse në fenë tonë. Nuk duhet të harrojmë që lutjet tona të fillojnë dhe të mbarojnë me salavate për profetin, duke ditur që lutja midis dy lutjeve të pranuara tek Zoti, pranohet.

*** Shkëputur nga libri "Ditët dhe netët e mira në Islam",
Botim i KMSH-së, 2007.**

Morali i lartë i Resulullahut dhe sjelljet e tij, që u bënë shkak për udhëzimin e njerëzve

Abdullah bin Selami (radjallahu anhu) ka thënë kështu: "Kur Allahu dëshiroi udhëzimin e Zejd bin Sunes, Zejdi tha: "Nga të gjitha shenjat e profetësisë, sado qofshin ato, përveç dy syresh, unë i kam dalluar të gjitha në atë fytyrën e bukur të tij. Për ato dy cilësi nuk kisha dëgjuar asgjë të thuej. Ato dy cilësi ishin të qenët i butë, i dashur dhe që butësia t'ia kalonte e ta mbulonte çdo çast nervozizmi dhe që gabimet dhe sjelljet e pahijshme që i bëheshin t'ia shtonin edhe më tepër butësinë e ndjenjën faljes." Ja se si vijon të tregojë Zejdi më tej:

"Një ditë, Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), bashkë me Aliun (radjallahu anhu), dolën nga porta e dhomës së njëres prej bashkëshorteve të tij. Në atë moment, aty pranë kaloi një beduin i hipur mbi deve, i cili u tha:

- "O i Dërguari i Allahut! Në aksh vend kisha disa njerëz të mitë, ishin bërë myslimanë. U pata thënë, 'nëse bëheni myslimanë, atëherë si malli, si pasuria do t'ju shtohen, do t'ju shumëfishohen'. Mirëpo, nga mungesa e shirave dhe thatësira ata kanë mbetur shumë ngushtë. O Resulullah, kam shumë frikë, se ashtu siç e pranuan Islamin nga tamahu për më shumë pasuri, mund të heqin dorë sërish e të kthehen edhe njëherë në fenë e tyre të mëparshme. Po deshe t'u dërgosh ndonjë ndihmë, mund të ma japësh mua e ua çoj unë."

Në atë kohë, i Dërguari i Allahut hodhi njëherë vështrimin nga Aliu (radjallahu anhu) që e kishte përkrah. Ai njeri i tha:

- "Nuk na ka mbetur më asgjë, o i Dërguar i Allahut!"

Atëherë unë (Zejd bin Sune) iu afrova dhe i thashë:

- "O Muhamed! A mundet, që, për njëfarë kohe, të na e shesësh një pjesë të hurmave të filanëve me një çmim të ulët?"

- "Mos më përcakto një vend të caktuar, si pemishtja e hurmave të filanit, apo të ndonjë tjetri.", – më tha i Dërguari i Allahut.

- "Në rregull.", – i thashë unë, dhe kësaj më morëm vesh. E hapa trastën dhe për një pjesë të hurmave, për një kohë të caktuar, i pagova plot tetëdhjetë mijë monedha floriri. Ndërsa ai ia dha të gjitha monedhat atij beduini, të cilit i tha:

- "Shko dhe ndihmoji ata njerëz të përmbushin nevojat e tyre!"

Zejd bin Suneja, në vijim, thotë: Kishin mbetur edhe dy-tër ditë nga koha që ishim marrë vesh për përdorimin e hurmave. Erdhën Profeti ynë bashkë me Ebu Bekrin, Omerin, Osmanin dhe disa sahabë të tjerë. Pasi falën namazin e xhenazes, u afruan të uleshin ndanë një muri. Shkova menjëherë pranë tyre dhe e kapa nga këmisha që kishte veshur, e pashë si me një fytyrë paksa të ashpër dhe i thashë:

- "O Muhamed, duhet të më paguash! Uallahi, ju bijtë e Abdulmuttalibit nuk dini gjë tjetër, veçse të shtyni pagesën e borxheve. Unë kam marrëdhënie të shumta me ju dhe ju njoh mjaft mirë."

Në atë kohë pashë njëherë edhe nga Omeri, sytë i lëviznin me rrëmbim, e dukej që ishte nevrikosur tej mase. Më hodhi një shikim dhe më tha:

- "More armik i Allahut! Si guxon t'i flasësh kështu



të Dërguarit të Allahut? Si guxon ta prekësh kështu të Dërguarin e Allahut? Të betohem për Allahun, se po të mos ngurroja se do të fillosh të urresh Islamin, do ta nxirrja shpatën nga brezi e do të ta kisha ndarë atë kokë nga ato shpatulla!

I Dërguari i Allahut po më shihte gjithë qetësi dhe me një seriozitet të pasqorë, i palëkundur. Pastaj pa njëherë nga Omeri dhe i tha:

- "Omer, neve na nevojitet diçka tjetër, jo kjo sjellje e jotja! Ti duhet të më këshilloje mua që t'ia paguaj borxhin këtij njeriu dhe atë ta këshilloje që ta kërkonte me të mirë kthimin e borxhit! Hajde, Omer, shko me të dhe paguaja sa i bën haka dhe t'i japësh edhe njëzet hurma më shumë, meqë e trembe!"

Omeri më mori me vete. Përveç asaj që më takonte, më dha edhe njëzet masa me hurma më shumë.

- "O Omer, po pse kaq shumë?", - e pyeta.
- "Kështu më porositi i Dërguari i Allahut.", - u përgjigj ai.
- "Meqë të trembe."
- "Po mua, nuk më njohë, o Omer?", - e pyeta unë.
- "Jo, nuk të njohë."
- "Unë jam Zejd bin Suneja."
- "Rabini?!", - pyeti ai i habitur.
- "Po, rabini Zejd."
- "Po pse u solle ashtu me të Dërguarin e Allahut, pse i fole ashtu?", - më pyeti ai.
- "O Omer, përveç dy shenjave të profetësisë, të gjitha të tjerat unë i kisha dalluar në fytyrën e ndritur të të Dërguarit

të Allahut që kur e takova atë për herë të parë. Por për këto dy shenja nuk kam dëgjuar kurrë asgjë: kur butësia ia mposht nevrkosjen dhe ajo e shtimit edhe më shumë të butësisë kur dikush tregohet i pasjellshëm me të, apo kur shfaq mungesë respekti. Ja pra, duke vepruar kështu, i mësova edhe ato. Ja, o Omer, të kam ty dëshmitar, se unë jam i kënaqur me Allahun si Zot, me Islamin si fe dhe me Muhamedin si profet dhe i Dërguar i Allahut. Të kam ty dëshmitar, që gjysmën e pasurisë, e ti e di se unë jam shumë i pasur, e jap si lëmoshë për umetin e Muhamedit!, - iu përgjigja unë.

- "Thuaj më mirë 'një pjesë të umetit të Muhamedit', se nuk mjaftojnë për të gjithë umetin e tij."

Kësisoj, edhe unë e rregullova atë shprehje të testamentit tim, duke thënë 'një pjesë të umetit të Profetit Muhamed'.

Transmetuesi i hadithit thotë: "Omeri dhe Zejdi (radijallahu anhumu) u kthyen tek i Dërguari i Allahut, Zejdi tha fjalën e dëshmisë, duke shpallur sakaq besimin e tij tek i Dërguari i Allahut. Kështu e shprehu ai besëlidhjen e vet. Dhe, tok me Profetin tonë, ai mori pjesë në shumë beteja që u bënë në emër të Islamit. Jetën e humbi gjatë betejës së Tebukut. Allahu e trajtoftë me mëshirë Zejdin."

Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"
M. Jusuf Kandeheui
Botim i KMSH

Njeriu vuan... nga zëmra!



"Themeli i lumturisë së vërtetë është në zemër" – Epictetus

Që njerëzimi është i sëmurë, dhe bile i sëmurë shumë rëndë, saqë ka rrezik të madh të përgjysmohet, s'ka më asnjë pikë dyshimi. Të gjithë e shohim dhe të gjithë e kemi parasysh jetën tonë të përditshme me plot hidhërime, mallëngjime, vuajtje e brenga, saqë arrijmë shpeshherë të mallkojmë orën në të cilën lindëm, fatin e zi që na mban ende gjallë dhe të shtyhem aq thellë në dëshpërim sa të lakmojmë para kohe jetën e qetë të të vdekurve...

Ç'është vallë arsyeja e kësaj gjendjeje shpirtërore e mendore që na ka kapur? Pse vallë njeriu, edhe mbas kaq mijëra vjetësh jetë të përbashkët punimi, shoqërimi, mësimi e diturie nuk e gjeti dot lumturinë dhe mirëqenien e tij në këtë botë, por i duhet vazhdimisht e ditë përditë të kacafytet me njëri-tjetrin, të vrasë shoqi-shoqin, të pushtojë i madhi të voglin, të mbytet i forti të dobëtin, të mendojë i pasuri të vobektin, të sundojë kombi kombin dhe, të gjithëve bashkë, që nga më i vogli tek më i madhi, të na brejë krimbi i nakarit, i dyshimit, i smirës, i hakmarrjes, i pasurimit pa të drejtë dhe i njëqindenjë epsheve shtazarake të jetës sonë më primitive?

Ç'u bënë ballë gjithë porositë e Profetëve, gjithë zbulimet filozofike të kaq filozofëve, gjithë udhëzimet edukative të pedagogëve, gjithë studimet shoqërore të të diturve, gjithë shpikjet e mëdha e të mrekullueshme të shkencëtarëve?

Që të themi se njeriut të gjithë këto mësimë nuk i zunë aspak vend në qenien e tij për mungesë truri, zgjuarsie apo mençurie, është një gjë krejt jashtë të vërtetës, në dritë të punëve të mrekullueshme mendore që njeriu ka kryer dhe po kryen përditë. Njeriu, kjo qenie kaq e vogël si esencë fizike, saqë mbytet dhe nga helmi i një arrëze apo grerëze të vogël, me mendjen e tij ka arritur të fluturojë në qiell si zog, të notojë në det si peshk, të matë thellësinë e detit, të përshkojë me vrull shigjete të gjithë madhësinë e botës, të matë nxehtësi, largësi, dritë e lëvizje të qindra-mijëra yjesh e planetësh në qiell, të dërgojë nga një kënd i botës në tjetrin me vrull vetëtime zërin e tij e mijëra të tjera veprime si këto, që dëshmojnë qartësisht se nuk mund të jetë kurrë i sëmurë nga trutë, i trashë nga kuptimi, i cekët nga gjykimi apo i mangët nga zgjuarsia. Bile, në dritë të këtyre shpikjeve dhe sendërtimeve të mëdha, duhet të pohojmë atë që është plotësisht e vërtetë, se njeriu në pikëpamje të zhvillimit mendor ka arritur

atë zhvillim aq të madh sa të mbetet i çuditur edhe vetë prej vetvetes së tij, prej veprave dhe realizimeve të tij.

Po atëherë, ku qëndron e meta fatale e njerëzimit, që, me gjithë zgjuarsinë e tij, njeriu nuk e gjen dot lumturinë e tij të vërtetë, mirëqenien e tij të plotë dhe përparimin, begatimin dhe qytetërimin e tij të përshtatshëm, por i duhet të gjendet në përleshje të përditshme e jo shumë larg dhe në luftëra të gjata e të përgjakshme?

Përgjigja e kësaj pyetjeje është një dhe e vetme: Njerëzimi vuan nga... zemra! Njeriu nuk vuan nga mendja, por nga shpirti, nga ndërgjegjja, nga moszhvillimi proporcional i mendjes me zemrën.

Njeriu, duke harruar se "themeli i lumturisë së vërtetë të njeriut është në zemër", siç e ka thënë i madhi Epictetus gati dymijë vjet më parë, iu dedikua kryesisht zhvillimit mendor, duke e lënë në radhë të dytë, për të mos thënë gati mbas dore, zhvillimin shpirtëror, ndjenjat fisnike të zemrës, që i japin njeriut cilësitë më kryesore të qenies së tij si njeri: bujarinë, dashurinë, sinqeritetin, mëshirën, faljen, pendimin, vullnetin me punë, me shërbim, me ndihmë e të tjera si këto. Dhe kështu na duallën në shesh me qindra njerëz midis nesh, më çdo anë e më çdo kënd – edhe ne vetë brenda – që janë gjigantë mendorë, por bibiqër shpirtërorë, gjeni në mendje, por daj në shpirt.

Njeriu, duke harruar se "mësimi pa të vërtetën duhet quajtur më mirë dinakëri sesa dituri", siç e ka thënë Platoni, i ra pas mësimit lëndor verbërisht dhe të Vërtetën e të Mirën; që janë dritat e pasosura të shpirtit dhe që i japin njeriut rrugën e mirësisë, i la mënjanë, në vend që t'i pasonte, t'i kërkonte, t'i përgjithësonte në turmën dhe t'i bënte udhëheqëset e tij të jetës. Këto ngelën vetëm si mësimë teorike të filozofëve, edhe këta të quajtur nga turma paturpësisht "të marrë dhe të çmendur"...

Dhe kështu, duke kalluar nga brezi në brez në kundërshtim flagrant me të vërtetat morale, që duhet të mbruhet në zemër të çdo njeriu, për të arritur atë qytetërim shpirtëror që sjell përparimin e vërtetë dhe mirëqenien e përgjithshme, mbërritëm në katastrofën morale, ku egoizmi sundon mbi çdo ndjenjë tjetër, ku çdo njeri, komb e shoqëri përpiket ekskluzivisht për vete, ku çdo mënyrë veprimi quhet e drejtë mjaft që t'i arrihet qëllimit dhe ku instinktët primitive të praktikuar përditë janë në disharmoni të plotë me përparimin lëndor. Arritëm pikërisht që, ndërsa ecim mbi shkallë të mermerta e të ndritura pallatesh, shpirtin na

nxin si një natë Shënëndreu; ndërsa bredhim e shëtisim nëpër bulevardë të gjerë e të shtruar me asfalt, mendja na shkon në një mijë e një të liga për shokun, për vëllanë, për mikun; hipokrizia dhe dallkaukllëku na u bënë qëllime kryesore të jetës në vend të sinqeritetit dhe zotësisë së vërtetë; edhe buzëqeshjen, që duhet të shprehte gazin e shpirtit dhe të zemrës, e bëmë një gjë normale, etikete, gënjeshtare. Në pikëpamje materializmi, pastaj shumë na hyri në shpirt lakmia për pasuri e ar, saqë u falmë këtyre çdo vlerë të jetës dhe vërtetuam plotësisht fjalën e Benjamin Franklin-it: "I cenuan nderin dhe qeshi, i morën të dashurën dhe prapë qeshi, kur i morën kuletën (të hollat) vrau veten."

Duke e lënë kështu pas dore edukatën e zemrës, ndjenjat e larta bujare u fikën një e nga një në shpirtin tonë dhe zemra, nga një organ shpirtëror mbeti një organ fizik, një pompë e thjeshtë për të qarkulluar gjakun. Ndjenjat bujare u shtypën me kohë dhe trenin e komandën e jetës njerëzore e mori në dorë logjika e akullt mendore, ajo që çdo gjë e mat me shifra, si tregtari me termat "fitim" ose "humbje", e jo me termat morale e mirë dhe e ligë, e drejtë dhe e shtrembër, e rreme dhe e vërtetë. Mësimi në shkollë më anë tjetër, u formalizua: jo kush di në të vërtetën e kush është formuar plotësisht në mendje e në shpirt e merr diplomën e tij, por kushdo që ka kujtesë të recitojë mësimet e profesorit mbas tekstit të këtij. Dhe kështu na duallën nga shkolla shumë shkollarë të pashkolluar, shumë diploma që s'janë dëshmi autentike zotësie pune dhe veprimi, mirësjelljeje dhe mirëshërbimi. Paraqitja e jashtme zuri vendin e esencës së brendshme; ai që di të vishet më mirë, të flasë më bukur fjalë të mëdha e të rrumbullakëta, të mbahet trupërisht i ngrehur e pispillosur, të reklamojë sa më shumë vetveten, u quajt nga shoqëria shumë herë më i mirë nga ai që nuk ka pamje e reklama të jashtme, por që në të vërtetë, ka zotësi të shërbejë më tepër, më drejt e më virtutshëm shoqërinë njerëzore...

Dhe kështu, dalëngadalë, edukata morale, që është baza e jetës shoqërore dhe themeli i qytetërimit të vërtetë, u përgjunj. Nderi u bë turp dhe turpi u bë nder. Fjala dhe besa mbetën kujtime të së shkuarës. Zemra si ndërgjegje heshti së punuari, a po e ndrydhur dhe e shtypur punon në drejtim çnjerëzor dhe të shtrembër. Dituria e njeriut, nga një vegël e dobishme për shoqërinë u kthye në rrënimin e shkretimin e saj. Shpikjet e mëdha, nga lehtësonjëse e shëronjëse të vuajtjeve njerëzore, u kthyen në vegla gjakatore, helmonjëse dhe prishëse të

jetës së njeriut dhe të qytetërimit të tij.

Nga kuadri i mësipërm nuk ngel asnjë dyshim se njerëzimi është i sëmurë nga zemra, dhe sëmundja është tepër e rëndë. Nuk kemi të bëjmë me një çrregullim të zemrës organike, që të marrim një mjek të zakonshëm që të na i vërë në rregull me pak pika "Cardiazol" a të ndonjë tjetër bari. Kemi të bëjmë me zemrën si ndjenjë e si shpirt, që do një kurë shekullore të gjatë e të kujdesshme që të vijë në rregull e në drejtimin e duhur. Kemi të bëjmë me një kujdesim të gjerë e të përgjithshëm, jo individual e të kufizuar. Puna është e rëndë dhe e vështirë, por duhet përballuar patjetër nëse duam ta shpëtojmë njerëzimin nga prishja e shkretimi.

Të shumta janë mënyrat që propozohen për ta shëruar njerëzimin nga plagët morale e shoqërore nga të cilat vuan tmerrësisht. Disa pandehin se fajin e kanë sistemet e punës, të qeverisjes, të organizimit e të tjera si këto dhe po të ndryshohen këto menjëherë do të lindë për njeriun pranvera e lumturisë. Psikologët shoqërorë, më anë tjetër thonë se asgjë s'mund të arrihet me të vërtetë pa u edukuar vetë natyra e njeriut. Është njeriu vetë ai që ka nevojë më tepër të kurohet sesa sistemet e tij shoqërore dhe organizative. Këto të fundit s'janë veç pjella direkte e qenies së tij.


"Të ndreqim njeriun, e pikërisht zemrën dhe shpirtin e tij", duhet të jetë urdhri ynë kategorik. Njeriu i keq e kthen dhe sistemin më të mirë në më të dëmshmin, ashtu sikundër njeriu i mirë ndrit si xhevahir dhe në botën më të keqe.

Por, që ta ndreqim njeriun shpirtërisht e ta shërojmë nga sëmundjet e zemrës, nuk është një punë e lehtë, që të përmblihet në dy fjalë. Problemi është i gjerë dhe i shumanshëm ashtu si ç'është e gjerë dhe e pakufizuar edhe natyra e njeriut. Prandaj, për këtë gjë duhet të një studim i madh. Ne mund të kthehemi sërish ndonjëherë tjetër mbi këtë temë për të dhënë dhe ndonjë element të ri.

Mjafton vetëm të ritheksojmë, si përfundim të këtij artikulli, se pa arritur njerëzimi që të edukohet nga zemra e nga shpirti si lypset, nuk duhet të presim – se presim më kot – që bota të bëhet një çerdhe lumturie e njerëzimi të gjejë prehje e qetësi. Bota do të ndreqet vetëm kur të ndreqet njeriu, dhe kushdo që do të japë një ndihmë drejt këtij qëllimi do të jetë me të vërtetë mirëbërësi më i madh i njerëzimit.

Beqir Haçi
Revista "Njeriu", nr. 10 (22), prill 1944





QAMIL BALA
(1878-1933)

Drejtor i Arsimit në Bagdad, Inspektor i Përgjithshëm i Arsimit në Siri, Drejtor i Gjmnazit në Jerusalem, mësues në Manastir e Selanik, Drejtor i parë i Medresesë së Tiranës, Deputet 1924.

Qamil Bala ka lindur në Gjilan, Kosovë më 1878. Pasi mori arsimin fillor në Prishtinë, përfundoi me sukses gjmnazin e Manastirit. Përfundimet e larta të shkollës së mesme, i hapën udhë për studime të larta pedagogjike në Stamboll. Gjatë viteve studentore ai do të mbante lidhje të ngushta e të pandërprera me vendlindjen. Këto lidhje dhe mjedisi i Stambollit, si qendër e rëndësishme ku jetonin e punonin përfaqësuesit më në zë të inteligjencës atdhetare shqiptare, e brumosën Qamilin si intelektual e atdhetar. Pasi kreu me sukses studimet e larta më 1904, zuri vend si mësues në gjmnazin Zosimea të Janinës. Me aftësitë intelektuale, profesionale e zellin për punë, ai u shqua ndërmjet kolegëve. Me paraqitjen e tij autoritare dhe të ngrohtë, i rreptë dhe i dashur, i drejtë dhe dashamirës, kërkues në disiplinë dhe tërheqës në mësim, ai do t'ia rriste së tepërmi emrin vetes ndërmjet nxënësve dhe mësuesve si një autoritet intelektual atdhetar.

Ai kishte lidhje me frashërlinjte e shquar, me Ismail Qemalin e më vonë me figura të tjera shqiptare si: Xhafer Ypi, Xhafer Vila, Demir Vila, Mustafa Kruja, Dinollarët e Çamërisë, Pertef Pogoni, Remzi Baçe etj. Zosimea në Janinë ishte qendra ku në format më të ndryshme, ushqehesh ndjenja dhe dashuria për çdo gjë shqiptare, nga punëtorët e luftëtarët e shquar të shqiptarizmit, ku bënte pjesë padyshim edhe Qamil Bala. Duke vlerësuar me notat më të çmuara ndihmesën e atëhershme të Qamil Balës, shumë vjet më vonë, gazeta "Ç" ka qenë Bajo Topulli për Shqipërinë e asaj kohe në Selanik, ka qenë edhe Qamil Bala në Janinë dhe gjetkë. Këta i mbanin gjallë dhe i lartësonin ndjenjat kombëtare në shpirtin e njomë të studentëve shqiptarë."

Shpejt, autoritetet e larguan Qamil Balën nga Janina dhe e çuan në gjmnazin e Manastirit dhe pastaj në gjmnazin e Selanikut. Ai i ishte përkushtuar në tërë jetën e tij, çështjes së atdheut, prandaj do të mbetej gjithnjë shtyllë e fortë e shqiptarizmit, duke u hapur sytë e zemrës dhe të mendjes të rinjve shqiptarë, që ishin në ato shkolla dhe duke mbjellë në shpirtin e tyre farën e dashurisë për atdheun. Më pas ai u çua në Palestinë, si drejtor i gjmnazit osman të Jerusalemit.

Pas shpalljes së kushtetutës së xhonturqve

më 1908, kur lëvizja atdhetare shqiptare merr hove të reja, mbledhet Kongresi i Elbasanit, i cili veç të tjerave, vendosi çeljen e Shkollës Normale të Elbasanit, në të cilën Qamili u caktua drejtor për meritat e tij. Qamil Bala do të lajmërohej telegrafisht për detyrën e re, por popullsia e Jerusalemit, e cila shpejt ia kishte njohur vlerat intelektualit shqiptar, nuk deshë që ta lejonte. Por Komisioni i Normales këmbënguli dhe së fundi autoritetet palestineze e lejuan Qamil Balën që të merre detyrën e re në atdhe. Megjithatë vështirësitë nuk kishin përfunduar. Pas një udhëtimit shumë të gjatë, arriti në Manastir. Xhonturqit me pretekste të ndryshme burokratike e ndalojnë dhe përfundimisht e pengojnë. Ndërkaq, koha kishte kaluar dhe drejtimin e Normales, siç dihet, e mori Luigj Gurakuqi.

Pas kësaj, Qamil Bala do të kthehej në Stamboll. Atje i doli emërimi për drejtor i përgjithshëm i arsimit në Irak me qendër në Bagdad. Ishte një vlerësim i madh që i bëhej një shqiptari. Nga viti 1915 deri në fund të Luftës së Parë Botërore, kreu detyrën e inspektorit të përgjithshëm të arsimit në Siri. Prandaj pas vitit 1920, si mjaft bij të tjerë, që ishin shpërndarë nëpër botë, do të kthehej edhe ai në atdhe. Por, me gjithë aftësitë e provuara në një karrierë të lartë arsimore, nuk parapëlqeu veçse vendin e një mësuesi fshati. Këmbëngulja, më mirë të thuash detyrimi i ministrit të Arsimit Rexhep Mitrovica, bëri që ai të niste punë si inspektor arsimit në qarkun e Elbasanit.

Si inspektor arsimit në Elbasan, Qamili do t'i kushtonte vëmendje të veçantë shkollës Normale, ku përgatiteshin mësuesit, aq e aq të nevojshëm për zhvillimin e arsimit në Shqipëri. Si inspektor, ai do të jetë shumë i vëmendshëm dhe tepër i kujdesshëm për mbarëvajtjen e shkollës së mirënjohur e sidomos për formimin atdhetar të nxënësve.

Në këtë kohë Qamil Bala caktohet nga Ministria e Arsimit së bashku me Jani Mingën e Sali Çekën, në komisionin për caktimin e teksteve shkollë të arsimit të mesëm. I ushqyer mirë me literaturë pedagogjike, ai u bë frymëzues e bashkëpunëtor i "Revistës pedagogjike". Me drejtuesit dhe bashkëpunëtorët e revistës, arriti të krijonte pranë Ministrisë së Arsimit një bibliotekë me literaturë pedagogjike.

Qytetar me reputacion të madh shumëplanësh, sidomos në zonën verilindore të vendit e posaçërisht në mbarë Kosovën, nga dhjetori 1922 Qamil Bala do të jetë deputet i Prefekturës së Kosovës, me qendër në Kukës në vend të Mustafa Krujës. Për këtë çështje, veterani i arsimit Jonuz

Blakçori thotë: "Përgjithësisht Parlamentit nëpër rrugë e rrethonte rinia, të cilës i jepte drejtime, i jepte kurajo, ia zgjidhte në këmbë të gjitha problemet e ndërlikuara, pengesat që i shfaqeshin dhe ashtu prapë nëpër rrugë, predikonte misionin e vet si edukator, si shkencëtar".

Me vizionet e tij përparimtare për shoqërinë shqiptare, Qamil Bala dha ndihmesë të çmuar për çelje shkollash e konviktesh të rëndësishme në kryeqytet.

Në vitet '20 të shek. XX ishte pjekur mendimi për të krijuar një shkollë të mesme fetare islame me fizionomi bashkëkohore. Iniciatorë të kësaj ndërmarrjeje u bënë personalitete të shquara të politikës shqiptare të atyre viteve. Me abrogimin e Kalifatit, ngritja e një shkolle të tillë shtrohej si një çështje emergjente. Grupi i iniciatorëve kryesorë përfaqësohej nga H. Vehbi Dibra, senatori Sali Vuçiterni, intelektualët e shquar Qamil Bala, Mehdi Frashëri, Ferit Vokopola etj.

Medreseja që do të ngrihej synonte të përgatiste elementë të ditur, të pajisur me njohuri të larta fetare, filozofike e shkencore, në përkatësi me arritjet e arsimit bashkëkohor.

Qamil Balës iu besua drejtimi i Medresesë së Tiranës më 1 mars 1924. Ai paraqiti planin mësimor të kësaj shkolle fetare, ku do të jepeshin lëndët: Kur'an, Fikh, Gjuhë Arabe, Gjuhë Shqipe,

Gjuhë Frënge, Historia e Shqipërisë, Gjeografi, Shkencat, Aritmetika e Gjeometria, Higjiëna dhe Lëndët e Djathtësisë (vizatim, gjimnastikë dhe muzikë).

Për nga programi dhe plani mësimor, kjo medrese ishte e barasvlershme me gjimnazet bashkëkohore. Në këtë traditë eci ajo, nga bankat e së cilës dolën njerëz të aftë, studiues, shkrimtarë e deri akademikë.

Iniciativa e dytë e rëndësishme e Qamil Balës, është themelimi i Gjimnazit të Tiranës. Në verën e vitit 1924, ndodhi që 46 të rinj nga Tirana e Durrësi, t'i kërkonin Ministrisë së Arsimit çeljen e një shkolle të mesme. Zërin e të rinjve tiranas e dëgjoi Bala me Sali Çekën dhe Pertef Pogonin. Shkolla arriti të çelet më 23 nëntor 1925, po me të tjerë drejtues, sepse Qamil Bala për shkaqe politike, në dhjetor 1924, do të largohej nga Shqipëria së bashku me të gjithë kundërshtarët politikë të Ahmet Zogut.

Në fillim, ai u vendos në Vjenë e më vonë qëndroi në Berlin. Por ai nuk hoqi dorë nga politika dhe përpjekjet e mëdha për çështjen kombëtare. Ai militoi në Kryesinë e Komitetit të Çlirimit të Kosovës së bashku me Bedri Pejandin dhe Ibrahim Gjakovën.

Që në fillim të veprimtarisë së tij, mori në mbrojtje interesat e vegjëlisë shqiptare, sidomos

ato të fshatit. Në deklaratën e përbashkët të bërë në Gjenevë pranë Lidhjes së Kombeve më 24 maj 1927, drejtuar gjithë popullit shqiptar, Komiteti i Çlirimit të Kosovës në bashkëpunim me Komitetin e Çlirimit Nacional, kërkonin së pari, që populli shqiptar të bëhej zot i fateve të tij në kufijtë etnikë dhe me një regjim republikan demokratik. Ai do të dënonte vazhdimisht padrejtësitë e Fuqive të Mëdha, të cilat merrnin nëpër këmbë fatet e popujve të vegjël. "Traktati i Berlinit e ka coptue Shqipërinë e ka da", do të shkruante Qamil Bala në "Federacioni Ballkanik". Të gjitha masakrat, rrafshimet, persekutimet, emigracionet dhe gjithë konsekuencat negative, që erdhën mbi popullin shqiptar, do të deklaronte Qamil Bala, rrodhën nga vendimet e Kongresit të Berlinit. "Unë kujtoj, - theksonte ai, - se politika evropiane në Ballkan në 30-40 vjetët e mramë, asht kenë në radhë të parë, se si me mujt me shitë armë në Ballkan". "Na popujt e Ballkanit duhet të ekzaminojmë mirë shkaqet e mjerimeve tona, me kuptue dhe marrë vesht mirë që kjenë politikajt evropianë që i sollën mbi kryet tonë këto mjerime të t'merrshme".

Por kryetema e luftës së tij vetjake politike, do të mbetet çështja e çlirimit të Kosovës nga zgjedha serbe. Për këtë çështje të madhe kombëtare, ai do gjente mënyrën të ngrinte zërin, deri në organizmat politike e shoqërore ndërkombëtare

Kur u kthye në atdhe, pas amnistisë që bëri Ahmet Zogu për kundërshtarët e tij politikë, Qamil Bala, i bindur thellë në rolin e madh vendimtar, që luan arsimi në jetën e vendit, me kompetencën e shkencëtarit, devocionin e fetarit, talentin e organizatorit dhe përkushtimin e reformatorit, u nis për udhë në këtë fushë.

Në fillim ai pranoi drejtimin e konviktit privat "Naim Frashëri" në kryeqytet dhe shumë shpejt pranë tij, çeli edhe një shkollë normale për vajza.

Qarqet përparimtare të vendit të cilat e njihnin mirë çfarë përfaqësonte Qamil Bala, e mirëpritën menjëherë iniciativën e tij të re.

Meritë e madhe e intelektualit të shquar demokrat në ngritjen e Institutit, ishte tërheqja me anën e Bashkive të ndryshme të vendit, të një numri të madh vajzash të zgjuara nga familje të vobekta me bursë shteti.

Ai mobilizoi 100 vajzat e konviktit për të hapur kurse të shkrim-këndimit shqip për të gjithë punëtorët e Tiranës, gjë e cila u vlerësua nga shumë gazeta të kohës.

Ai ndërroi jetë në vitin 1933. Tirana e përcolli me nderime të mëdha. Disa gazeta kryesore të Tiranës e përcollën në faqet e tyre me fjalë prekëse humbjen e Qamil Balës.

Idhujt e gjallë

Lat, Uzza, Menat

Kurani i emërton në veçanti tre idhuj. Por, pse? Sipas renditjes së shpalljes, emrat e idhujve për herë të parë përmenden në suren Nexhm. Pra, gjatë gjashtë viteve të Shpalljes, askund nuk përmenden emrat e idhujve. Për herë të parë përmenden në suren Nexhm: **“E ju, a i shihni Latin dhe Uzanë? Dhe atë të tretin e të fundin, Menatin (a kanë fuqi si Zoti i Muhammedit, e ju i konsideroni zota!)”** (Nexhm, 19-20) Pastaj, pason shpjegimi kush janë ata: **“Ata (që i adhuroni ju) nuk janë tjetër, vetëm se emra që ju dhe prindërit tuaj i emërtuat; Allahu nuk zbriti për ta ndonjë fakt. Po ata (idhujtarët), nuk ndjekin tjetër vetëm se paragjyqime dhe çka duan vetë, megjithë prej Zotit të tyre u pat ardhur udhëzimi.”** (Nexhm, 23)

Emra që ata i emërtuan (esmaen semmejtumuha). Atë që epshet e tyre dëshiruan (tehvel-enfus).

Andaj, idhulli nuk është tjetër pos emër i epsheve dhe dëshirave që gjinden në botën e brendshme të njeriut. Njerëzit këtyre emrave u japin rëndësi duke iu dhënë prestigj dhe i adhurojnë.

Nuk depërtojnë në këta emra dhe krijojnë paragjyqime rreth tyre, të cilët anojnë t'i copëtojnë nga atomi. Të

thyesh idhujt d.m.th. të rrënosh paragjyqimet rreth vetes.

Edhe pse idhujt janë vetëm disa emra, simbolet e të cilëve pjesa e jashtme e pasioneve dhe dëshirave të bërë nga druri dhe gurët, por përse këta idhuj Lat, Uzza dhe Menat të bërë nga druri dhe guri edhe sot e kësaj dite valviten, përse këta emra përmenden në Kuran, cila është rëndësia e tyre?

Këta idhuj duhen me qenë të gjallë, vinë nga dëshira e nefsit, “emërtimi” i tyre bart kuptim dhe janë lëndë adhurimi.

Dhe kjo çfarë kuptimi! Dhe kjo çfarë adhurimi! Të shohim!

Fjala “Lat” etimologjikisht është version i kthyer që d.m.th. “Zot” dhe paraqet autoritet absolut (ilah). Rrënja e fjalës arabe që është shërbyer për termin e përmendur arrin deri te prejardhja hebraike në periudhën antike dhe paraqet “gjë me të cilën udhëhiqet nga brenda” d.m.th. bindje absolute, autoritet. Pra, emri “Lat” është ekuivalent i fjalës “autoritet” të cilin ne e përdorim sot.

Fjala “Uzza” e plotëson. Në Kuran përmendet me

kuptimin "aziz" e që nënkupton "forcë", "fuqi". Emri "Uzza" është ekuivalent i asaj që ne sot e quajmë "forcë", "fuqi".

Ndërsa, emri "Menat" është shumë i njohur. Kjo është ajo që ne e quajmë "para" (Menna, Mamun, Money, Manat). Valuta e mbretërisë ruse ka qenë "manat". Sot, Azerbejxhani dhe Turkmenistani shërbehen me valutën "menat".

Andaj:

Lat - Pushtet;

Uzza - Forcë;

Menat - Para.

E lexojmë edhe njëherë versetin me kuptimin e sotëm: Autoritet, forcë dhe para. Këta nuk janë asgjë tjetër pos emra që ju dhe pasardhësit tuaj u keni dhënë. Këta janë të dyshimtë dhe pjesë e dëshirës së nefseve. Dëshirat dhe pasionet janë pushteti, forca dhe paratë. Për t'i arritur, sytë e tyre nuk shikojnë asgjë tjetër dhe si lëndë adhurimi krijojnë nga ata idhuj. Dëshirojnë për vete të marrin pushtet, forcë dhe para. Nuk ka kostum që nuk e veshin për të grabitur këto. Për këto luftojnë, goditen, derdhin gjakun dhe bëjnë çregullime.

Autoriteti: shteti, sundimi, froni, lideri, sovraniteti, kufiri, kombi.

Forca: armët, nafta, toka, banorët, penetrimi;

Paraja: kapitali, banka, ari, argjendi, dollari, euro.

A thua për shkak të këtyre nuk derdhet gjaku dhe bëhen çregullimet? Keni kujdes në periudhën në të cilën jetojmë. Nga forca e adhurimit lindi fashizmi. Nga lakmia për para lindi kapitalizmi. Problemi i përhershëm i njerëzimit nuk është asgjë pos këto tri: Lat (pushtet), Uzza (forcë) dhe Menat (para).

Çfarë thotë Kurani kundër këtij treshi?

La ilahe il-lall-llah - Nuk ka autoritet pos Allahut.


La havle ve la kuvvete il-la bil-lah - Fuqia dhe forca është vetëm e Allahut.

Lehul Mulk - Pushteti është i Allahut.

A kemi kuptuar përse emra e tyre janë të përmendur në Kuran? Këta janë emra që nuk vdesin te njerëzimi. Gurët u zhdukën, por jo edhe froni. Këta janë idhuj të gjallë: Lat, Uzza dhe Menat . . .

Përktheu: Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi

KUJDESI PËR JETIMIN



Profeti ynë i dashur, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, ndjente një dhembshuri të madhe ndaj fëmijëve jetimë. Ndaj tyre ishte shumë, shumë dashamirës. Ngaqë dhe vetë ai u vetëm dhe e kuptonte fare mirë se ç'do të thotë të jesh jetim. E dinte shumë mirë se sa e dhimbshme dhe e vështirë ishte kjo ndjenjë. Nga mëshira e madhe që kishte për jetimët, vazhdimisht i mbronte ata dhe kur atyre u bëhej ndonjë padrejtësi, gjithmonë kërkonte të drejtat e tyre.

Fëmijët e shokëve të tij, të cilët binin dëshmorë nëpër luftëra mbeteshin jetimë Profeti a.s. interesohej shumë, kujdesej për ta, kurrë nuk i linte vetëm dhe ua plotësonte nevojat e tyre. Disa prej tyre i merrte nën kujdestarinë e tij.

Teksa po dilte nga xhamia pas namazit të Bajramit, Profeti a.s., pa fëmijët që po luanin me gaz e hare. Ndërkohë i tërhoqi vëmendjen një fëmijë i mbështetur pas murit, me rroba të grisura e në gjendje të mjerueshme, duke qarë. Iu afrua atij dhe i tha:

- Vogëlush! Çfarë ke? Pse rri i mërzhitur? Përse nuk luan me shokët e tu?

Fëmija ishte jetim. Babai i tij kishte rënë dëshmor në luftën e Uhudit, nëna e tij ishte martuar me një tjetër dhe ai kishte mbetur i vetëm. Profeti ynë i dashur i kapi dorën dhe i ledhatoi kokën duke i thënë:

-Pse qan? A nuk do që babai yt të jem unë, nëna jote Aishja dhe motra jote të jetë Fatimja?

Fëmija nga gëzimi i madh sa s'po fluturonte. I emocionuar ia ktheu:

- E si të mos jem i kënaqur, o Profet i Zotit?

Profeti e mori fëmijën dhe e çoi në shtëpinë e tij. E ushqeu dhe e veshi. Tanimë që ishte i ngopur dhe i mbrojtur, doli përsëri që të luante me fëmijët e tjerë. Pse të mos gëzohej? Babai i tij kishte ikur në Parajsë (Xhenet), por tani në vend të tij ishte babai më i mirë në botë.

Kur fëmijët e tjerë vunë re tek ai ndryshimin, u mblodhën rreth tij dhe me kuriozitet e pyetën:

-Ti më parë vetëm qaje, kurse tani je ndryshe. Vallë ç'të ka ndodhur?

- Isha i etur, u ngopa, isha i zhveshur, u veshja, isha jetim, tani Profeti i Zotit është

babai im dhe Aishja është nëna ime, - tha ai i lumtur.

Pas kësaj, fëmijët duke lakmuar fatin e shokut të tyre jetim thanë:

-Ah, sikur dhe baballarët tanë të ishin dëshmorë dhe ne të kishim fatin e të pasurit një baba të tillë!

Fëmija ndenji pranë Pejgamberit a.s. derisa ai ndërroi jetë.

Sikur vetëm kokën ti ledhatosh një jetimi fiton një sevap shumë të madh dhe pikërisht ky gjest është sihariq për Xhenetin.

Profeti ynë a.s. shprehet kështu për këtë sevap të madh:

"Kush ledhaton kokën e një jetimi, vetëm për të fituar kënaqësinë e Zotit, për të ka aq sevape sa flokët që prek dora e tij. Ai njeri që i bën mirësi jetimit pranë tij, në Xhenet do të jetë afër meje si këto dy gishta" dhe më pas tregoi afërsinë e dy gishtave.

Kush e blen këtë skllav?

Profeti a.s. kishte një skllav me emrin Zahire. Zahire jetonte në shkretëtirë. Herë pas here, ai i sillte të Dërguarit të Allahut dhurata nga lulet dhe frutat e shkretëtirës. Pejgamberi gjithashtu e gëzonte me dhurata, të cilat ishin të nevojshme në shkretëtirë. Zahire ishte njëri ndër sahabet me të cilin Profeti bënte shumë shaka. Dhe thoshte për të:

- Zahire është shkretëtira jonë, ndërsa ne jemi qyteti tij.

Zahire i cili merrej me tregti, sërish një ditë kishte ardhur në qytet për të shitur ca gjëra. I Dërguari i Allahut, pa e parë ai, i shkoj nga mbrapa dhe pasi e kapi nga krahët, i mbylli sytë. Zahire i shqetësuar, duke thënë:

- Kush je ti? Më lëshol u kthye mbrapa.

Kur pa që ishte i Dërguari i Allahut u qetësua dhe e vendosi kokën në kraharorin e Tij të mëshirshëm.

I Dërguari i Allahut e vazhdoi shakanë duke pyetur:

- Kush e blen këtë skllav?

Dhe Zahire iu përgjigj:

-Nuk do të gjeni ndonjë blerës, o i Dërguar i Allahut. E çfarë vlere kam unë?!

I Dërguari i Allahut tha:

-Ndoshta në pamje ashtu je, por tek Allahu je një rob (skllav) i shtrenjtë e me vlerë të madhe.

